




RAPORT VJETOR

për gjendjet në sferën e të drejtave të njeriut
në Republikën e Maqedonisë në vitin 2016



Botues:

Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut i Republikës së Maqedonisë i përfaqësuar nga Prof. Dr. Gordan Kallajxhiev, kryetar

Redaktor:

Uranija Pirovska


Drejtoare Ekzekutive e Komitetit të Helsinkit për të Drejtat e Njeriut të Republikës së Maqedonisë

Dizajnin grafik dhe shtypjen:

Relativ

PËRMBAJTJA:

I.TË DREJTAT CIVILE DHE POLITIKE	5
II. GJYQËSORI	8
III. KUSHTETUTA DHE LEGJISLACIONI	17
IV. INSTITUCIONET E MBYLLURA DHE MALTRETIMI	23
V. DISKRIMINIMI	29
VI. TË DREJTAT EKONOMIKE DHE SOCIALE	37
VII. GJUHA E URREJTJES	44
VIII. VEPRAT E URREJTJES	48
IX. DHUNA ME BAZË GJINORE	51
X. KRIZA E REFUGJATËVE	55
XI. PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME	60

A decorative graphic consisting of numerous light gray, curved lines that sweep across the bottom half of the page, creating a sense of movement and depth.

1. Hyrje

Gjatë vitit 2016, duke pasur parasysh intensitetin e krizës politike, u organizuan një numër i madh i tubimeve publike, me qëllim që të shprehej revolta ndaj politikave të strukturës aktuale qeverisëse. Gjegjesisht, të inkurajuar nga e drejta e tyre e garantuar kushtetuese për tubim publik, qytetarët, për arsye të shumta, vunë në pah shkeljen sistematike të të drejtave dhe lirive të njeriut në shtet, në pothuajse të gjitha segmentet e shoqërisë.

Protestat, që filluan në vitin 2015, u intensifikuan në vitin 2016, si reagim ndaj vendimit të Presidentit të Republikës së Maqedonisë, Gjorge Ivanov, për falje kolektive të 56 kryerësve të dyshuar të veprave penale, për të cilat janë parashtruar kallëzime penale dhe janë ngritur procedura penale, e të cilët janë anëtarë dhe funksionarë të lartë ose bashkëpunëtorë të afërt të partive më të mëdha politike në vend.

2. Protesta

2.1 Protesta dhe kundërprotesta para Gjykatës Kushtetuese

Gjatë vitit 2016, u mbajtën më shumë protesta, si reagim ndaj vendimit të Gjykatës Kushtetuese për hapjen e procedurës për vlerësimin e kushtetutshmërisë së ndryshimeve në Ligjin për falje të vitit 2009. Protesta, që duheshte të mbahej më 15 mars të vitit 2016, pak para sjelljes së vendimit të Gjykatës Kushtetuese, u parandalua nga një grup tjetër qytetarësh - kundërprotestues, të udhëhequr nga lideri i partisë politike GROM (Opcioni qytetar për Maqedoninë), Stevço Jakimovski. Duke pasur parasysh faktin që për protestën e planifikuar, u njoftua në mënyrë të rregullt Ministrina e punëve të brendshme dhe për të njëjtën ishin njohtuar edhe mediat, e më pas vendi i protestës u mor nga persona të tjerë me qëllim krejtësisht të kundërt, mund të konkludohet se ekzistojnë indikacione serioze për kryerjen e veprës penale – Parandalim ose pengim i protestës publike - neni 155 i Kodit Penal. Edhe në këtë rast, Prokuroria Publike nuk e informoi opinionin nëse kishte vepruar sipas detyrës zyrtare dhe nëse kishte hapur hetim kundër organizatorit dhe pjesëmarrësve në kundërprotestë.

2.2. Protestat pas vendimit për falje kolektive të shpallur nga Kryetari i RM-së

Duke filluar nga data 13.04.2016, deri në fund të korrikut 2016, u mbajtën protesta, të njohura si Revolucioni shumëngjyrësh, si reagim ndaj vendimit të Presidentit të Republikës së Maqedonisë, Gjorge Ivanov, për faljen kolektive të 56 autorëve të dyshuar të veprave penale, për të cilat janë ngritur kallëzime penale dhe kanë filluar procedime penale, e të cilët janë anëtarë dhe zyrtarë të lartë ose bashkëpunëtorë të ngushtë të partive më të mëdha politike në vend.

Nga informatat e gjertanishme, me të cilat disponon Komiteti i Helsinkit, në lidhje me protestat e Revolucionit shumëngjyrësh, deri më tani, 37 persona që ishin pjesë e këtyre protestave janë akuzuar penalisht për pjesëmarrje në turmë që do të kryejë vepër penale. Përveç kësaj, më shumë se 50 persona përballen me ndëshkime financiare për shkelje të Ligjit për Pastërtinë Publike dhe Ligjit për Kundërvajtje kundër Rendit Publik.

Oficerët e policisë, disa herë me rradhë, parandalonin qytetarët të protestojnë në vende ose institucione të caktuara, duke kufizuar të drejtën e tyre për të lëvizur. Për shkak të kësaj, mund të konkludohet se ka indikacione serioze për kryerjen e veprës penale Parandalim ose pengim i protestës publike - neni 155 i Kodit Penal. Edhe në këtë rast, Prokuroria Publike nuk e informoi opinionin nëse kishte vepruar sipas detyrës zyrtare dhe nëse kishte hapur hetim kundër oficerëve të policisë.

3. Mbrojtja penale-juridike e lirive dhe të drejtave të qytetarëve

Sa i përket vetëdijes së qytetarëve për mundësinë e mbrojtjes penale-juridike të lirive dhe të drejtave të tyre, veçanërisht në lidhje me përdorimin e tepruar të forcës nga ana e oficerëve të policisë, për ndalimin e pabazuar ose pengimin e një tubimi publik, mund të konkludojmë se është në nivel të ulët.

Gjegjësisht, sipas të dhënave që janë marë në Ministrinë e punëve të brendshme, për një pjesë të veprave penale, nuk ka asnjë parashtrësë, kurse në mesin e tyre janë veprat penale të nenit 138 - "Shkelja e së drejtës për të përdorur gjuhën dhe alfabetin", nenit 150 - "Zbulim i paautorizuar i fshehtësisë", nenit 153 - "Shkelja e së drejtës për të paraqitur mjet juridik", nenit 154 - "Pengim i botimit dhe shpërndarjes së materialeve të botuara", nenit 155 - "Ndalimi ose pengimi i një tubimi

publik” dhe nenit 156 - “Shkelja e të drejtës së grevës”.

Në mesin e veprave penale që kanë vetëm disa parashtresa, janë veprat penale të nenit 137 - “Shkelja e barazisë së qytetarëve” (një parashtresë në 2014), nenit 142 - “Tortura dhe trajtime dhe dënime të tjera mizore, çnjerëzore ose degraduese” (nëntë parashtresa në 2010, tri parashtresa në vitin 2013 dhe dy në vitin 2014), nenit 146 - “Bastisje e kryer në mënyrë të paligjshme” (një parashtresë në 2013 dhe një në vitin 2016), nenit 147 - “Shkelje e sekretit të letrave ose dërgesave të tjera” (një në vitin 2012), nenit 148 - “Publikim i paautorizuar i të dhënave personale” (një në vitin 2013), nenit 151 - “Përgjim dhe audio regjistrim i paautorizuar” (një parashtresë në vitin 2015) dhe nenit 157-v - “Pirateria në fonogram” (dy parashtresa në vitin 2010). Të dhëna të tilla përsëriten edhe në Prokurorinë Publike, e cila, nga ana tjetër, nuk ka praktikë të inicojë procedura sipas detyrës zyrtare për të verifikuar përgjegjësi penale për shkeljen e të drejtave dhe lirive të njeriut¹.

Mungesa e plotë e parashtresave për disa vepra penale, ose numri shumë i vogël i tyre, është për t’u habitur, kur merret parasysh se disa dukuri konsiderohen shumë kritike, siç është shembulli me përgjimin e paautorizuar, i cili ka qenë një problem famëkeq për vite, problemi i barazisë së gjuhëve, në të cilin janë të ndjeshme pakicat kombëtare dhe problemi i torturës dhe keqtrajtimit në shërbim, i cili është shënuar në një seri raportesh për shkeljen e të drejtave të njeriut të përgatitura nga organet dhe organizatat vendase dhe ndërkombëtare, por edhe në vendimet e Gjykatës Evropiane në Strasburg.

1 Analizën e plotë për mbrojtjen penale-juridike për veprat penale kundër lirive dhe të drejtave të njeriut mund ta lexoni në linkun në vazhdim: <http://mhc.org.mk>

II. GJYQËSORI

2.1 Mungesa e paanshmërisë dhe pavarësisë në Këshillit Gjyqësor

Në fillim të janarit, Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut i shpalli vendimet për lëndët e pesë gjyqtarëve të shkarkuar, kundër Republikës së Maqedonisë: (Gerovska-Popcevska kundër Republikës së Maqedonisë, aplikacioni nr. 48783/07, Jakshovski dhe Trifunovski kundër Republikës së Maqedonisë, aplikacioni nr. 56381/09 dhe 58738/09 dhe Poposki dhe Duma kundër RM-së, aplikacioni nr. 69916/10 dhe 36531/11). Në të pesë çështjet, Gjykata verifikoi shkelje të nenit 6, alinea 1 (e drejta për një gjykim të drejtë) nga Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut, e cila konfirmon pretendimet për mungesë të pavarësisë dhe paanshmërisë së Këshillit Gjyqësor.

Në çështjen e parë, gjyqtarja Gerovska Popçevska është ankuar për pjesëmarrjen e kryetarit të Gjykatës Supreme dhe Ministrit të Drejtësisë (të cilët janë anëtarë të Këshillit Gjyqësor sipas detyrës zyrtare) në vendimin e Këshillit Gjyqësor për shkarkimin e saj, kur që të dy, nga pozicionet e mëparshme, veç më kishin formuar dhe shprehur mendim negativ për të. Në katër çështjet e tjera, gjyqtarë të caktuar, kanë qenë të shkarkuar me vendim unanim të Këshillit Gjyqësor, në përbërje të të cilit ka marrë pjesë edhe propozuesi i masës së tillë. Ankesat ndaj shkarkimit, të cilat gjyqtarët e shkarkuar i dorëzuan në Këshillin për ankesa të Gjykatës Supreme, u refuzuan të gjitha.

Këto raste kanë ndikuar që Këshilli Gjyqësor të marrë kritika të ashpra nga opinioni profesionist dhe ndërkombëtar për ndikimin e ekzekutivit në vendimet për përgjegjësinë disiplinore dhe shkarkimin e gjyqtarëve. Për këto arsye, u inicua ndryshim i tërë procedurës për verifikimin e përgjegjësisë disiplinore dhe shkarkimin e gjyqtarëve dhe formimi i një organi të ri – Këshillit për verifikimin e fakteve, i cili mund të ngrejë procedurë për verifikimin e përgjegjësisë së një gjyqtari përpara Këshillit Gjyqësor. Ndryshimet e këtyra ligjore u miratuan në një procedurë të shpejtë dhe të shkurtuar, pa konsultime me palët e interesuara dhe pa diskutim publik, andaj ato përmbajnë mangësi të shumta siç janë zgjidhjet e paqarta ligjore, veçanërisht në pjesën e formimit të Këshillit për verifikimin e fakteve. Në një situatë të tillë, mund të konkludohet se nuk është arritur qëllimi i përmirësimit të pavarësisë dhe autonomisë së sistemit gjyqësor dhe se formimi i Këshillit të ri për verifikimin e fakteve aspak nuk e arrin qëllimin e sigurimit të pavarësisë në sjelljen e vendimeve.

2.2 Rizgjedhje e paligjshme e kryetarit të Këshillit të Prokurorëve Publikë

Më 22 shtator, gjatë një seance të përbërjes së re të Këshillit të Prokurorëve Publikë të Republikës së Maqedonisë, në një votim të fshehtë, z. Petar Anevski u rizgjodh për kryetar të Këshillit. Rizgjedhja pasoi, pavarësisht faktit se sipas nenit 8, paragrafit 3 të Ligjit për Këshillin e Prokurorëve Publikë (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 150/2007 dhe 100/2011), mandati i kryetarit të Këshillit zgjat dy vjet, pa të drejtë rizgjedhjeje. Për këtë arsye, Komiteti i Helsinkit u bëri thirrje anëtarëve të Këshillit të Prokurorëve Publikë të Republikës së Maqedonisë, në përputhje me nenin 10, paragrafin 3 të Ligjit për Këshillin e Prokurorëve Publikë, të caktojnë një seancë urgjente për të rishqyrtuar vendimin e tyre të paligjshëm. Pas reagimit publik, z. Anevski për mediat deklaroi se nuk ishte e vërtetë që ai ishte zgjedhur në mënyrë të paligjshme. Sipas tij, përkundër faktit që ai ishte Kryetar i Këshillit të Prokurorëve Publikë deri në Gusht 2016, rizgjedhja është në një mandat të ri, të tretë të Këshillit, që do të thoshte që ai nuk u rizgjodh në të njëjtin mandat.

2.3 Procedurë joefikase për përzgjedhjen e kandidatëve për trajnim fillestar në Akademinë për Gjyqtarë dhe Prokurorë Publikë

Në nëntor 2015, Akademia për Gjyqtarë dhe Prokurorë Publikë shpalli një njoftim për pranimin e 30 dëgjuesve për trajnim fillestar në Akademinë për Gjyqtarë dhe Prokurorë Publikë. Sipas njoftimit të publikuar në webfaqen e Akademisë me 04.07.2016, opinioni u informua se pas kryerjes së pjesës me shkrim dhe me gojë të provimit, Komisioni për provimin pranues përpiloi një listë të notave të kandidatëve nga pjesa me shkrim dhe me gojë e provimit pranues. Pas publikimit të listës, në Komisionin e provimit pranues u dorëzuan gjithsej 44 parashtresa, në Këshillin drejtues të Akademisë u dorëzuan 29 ankesa, 9 kandidatë inicuan procedime para Gjykatës Administrative, e disa prej tyre edhe në Gjykatën e Lartë Administrative.

Përkundër afateve të shkurtra ligjore për të vendosur mbi parashtresat, ankesat dhe aktpaditë e kandidatëve të pakënaqur për pranim në Akademinë për Gjyqtarë dhe Prokurorë Publikë, korniza ligjore për përfundimin e tërë procedurës u tejkalua

disa herë. Edhe pse sipas Ligjit për Akademinë për Gjyqtarë dhe Prokurorë Publikë, e gjithë procedura e ankimimit nuk guxonte të zgjaste më shumë se 2 muaj, e gjithë procedura u shty deri në shkurt 2017, dhe gjenerata e re e kandidatëve për gjyqtarë dhe prokurorë publik trajnimin e filloi në mars 2017. Prandaj, kandidatët e rinj trajnimin e filluan me vonesë prej 6 muajsh, që është edhe një tregues tjetër i joefikasitetit të sistemit gjyqësor në zbatimin e reformave gjyqësore, të cilat parashikojnë që të gjithë gjyqtarët dhe prokurorët publik të sapoemëruar, të përfundojnë trajnimin në Akademi.

Më 29 gusht 2016, Akademia shpalli një njoftim të ri për pranimin e 60 dëgjuesve për trajnimin fillestar - kandidatë për prokurorë publik. Duke pasur parasysh që procedura lidhur me shpalljen e mëparshme nuk kishte përfunduar, kandidatët që kishin aplikuar në njoftimin e parë, nuk patën mundësinë të aplikojnë në shpalljen e re për pranimin e kandidatëve për prokurorë publik.

2.4 Prokuroria Speciale Publike

Më 15 shtator 2015, Parlamenti i Republikës së Maqedonisë me 111 vota “për” miratoi Ligjin për Prokurorinë Publike për ndjekjen e veprave penale në lidhje me dhe që rrjedhin nga përmbajtja e përgjimit të paligjshëm të komunikimeve. Në krye të këtij institucioni u zgjodh prokurorja Katica Janeva nga Prokuroria themelore publike Gjevgjeli, përzgjedhje nga e cila asokohe, të paktën në dukje, ishin të kënaqura të gjitha palët në skenën politike. Formimi i këtij institucioni ishte pjesë kyçe e Marrëveshjes së Përzahinos, binari kryesor nëpërmjet të cilit duheshte të dilet nga kriza politike. Ekipi i Janevës u kompletua me 12 prokurorë të tjerë, duke përfshirë prokuroret Fatime Fetaj dhe Lençe Ristovska, dy prokurore të reja, të eksponuara, që e kompletin tani më treshen popullore të drejtësisë që duhej të hedh dritë mbi dyshimet tepër të komplikuar dhe të ngatërruara për krimin dhe korrupsionin nga përfaqësues të lartë shtetëror, që dolën nga “bombat” e opozitës.

Deri më datën 15 Mars 2017, Prokuroria speciale publike zhvilloi procedura paraprake hetuese kundër 112 personave, kurse 50 persona janë subjekt i procedurave hetimore. Ndërkohë, ekipi i Prokurorisë arrin shifrën 117 persona, përfshirë këtu edhe ekipin hetimor dhe të akuzës. Deri në datën e dorëzimit të raportit të dytë gjashtëmujor (15.03.2017), ishte analizuar përmbajtja e 272,950 audio inçizimeve, gjegjësisht në përpunim e sipër janë 45% e numrit të përgjithshëm të

audioinçizimeve me të cilat disponon kjo Prokurori Publike.

Që nga hartimi e deri në mbylljen e këtij raporti, Prokuroria speciale publike përballet me pengesa dhe sabotime nga më shumë institucione, bashkëpunimi i të cilave është thelbësor për arritjen e rezultateve të pritura. Drejtoria e Sigurisë dhe Kundërzbulimit, një kohë të gjatë nuk bashkëpunon me Prokurorinë speciale publike, nuk pranon postë, kështu që prokuroria është e detyruar të kërkojë informata dhe materiale përmes Ministrisë së punëve të brendshme. Pas marrjes së lejes gjyqësore, Prokuroria zhvilloi një kontroll në mjediset e Drejtorisë së Sigurisë dhe Kundërzbulimit. Prokuroria Themelore Publike për Ndjekjen e Krimit të Organizuar dhe Korrupsionit gjithashtu vononte dorëzimin e çështjeve që ishin nën juridiksionin e Prokurorisë speciale publike.

Pengesa më e madhe me të cilën po përballet Prokuroria speciale publike (PSP) është Gjykata Themelore Shkupi 1. Gjykata hodhi poshtë pothuajse të gjitha kërkesat për shqiptimin e paraburgimit dhe masat për kujdes të cilat i kërkoj PSP-ja, kurse u zbatuan edhe emërime kontroverze të gjyqtarëve në departamentin e krimit të organizuar. Një pjesë e opinionit, këto shpërndarje të gjyqtarëve, i cilësoi si “spastrime” të gjyqtarëve “të papërshtatshëm” të cilët do të vendosnin (ose kishin vendosur tashmë) pozitivisht mbi propozimet e PSP-së.

Ndodhi edhe një precedent në funksionimin 72-vjeçar të Gjykatës. Ushtruesja e mëparshme e detyrës, kryetarja Tatjana Mihajlova, gjyqtare në njërin nga të dy çështjet e prokurorisë për të cilat tashmë janë ngritur akuza, gjobiti prokuroret Janeva dhe Fetai me nga 2000 euro secilën, për mosrrespektim të Gjykatës.

Ndërkohë, kjo Prokurori Publike merr mbështetje të hapur nga faktori ndërkombëtar, kryesisht nga përfaqësuesit e BE-së dhe SHBA-ve, të cilat, si mbrojtëse të Marrëveshjes së Përzahinos, funksionimin e papenguar të PSP-së (e cila ka afat ligjor që deri në qershor të vitit 2017 të dorëzojë aktipadi) e konsiderojnë si kusht kryesor për të aktivizuar procesin e ngrirë që moti të vendit, për integrimin Euro-Atlantik.

Përfundimisht me muajin mars të vitit 2017, përmes konferencave për shtyp, PSP-ja prezantoi 16 lëndë:

1. TITANIKU - Rasti i parë i PSP-së, në të cilin ekziston dyshimi se një grup i udhëhequr nga ish-ministrat e Ministrisë së punëve të brendshme, Ministrisë së punës dhe politikës sociale dhe sekretarit të Qeverisë kanë kryer mashtrime zgjedhore. Disa nga veprat janë lëshimi i paligjshëm i letërnjoftimeve, dhuna, marrja e mitos, futja në listë zgjedhore, e të tjera.

2. TNT - Çështje për prishjen e paligjshme të objektit Kosmos në pronësi të biznesmenit Fiat Canovski. Të dyshuar janë ish-Kryeministër, ish-Ministër i Ministrisë së punës dhe politikës sociale si dhe kryetari aktual i komunës së Gazi Babës.

3. TRANSPORTUES - Sipas PSP-së, komuna e Manastirit ka paguar “mbase transportin më të shtrenjtë të nxënësve në botë”. Të dyshuar për dëmtimin e buxhetit janë kryetari i Komunës së Manastirit, i cili një periudhë ishte edhe në arrest shtëpiak, si dhe kryetari i komisionit të furnizimeve të komunës.

4. FORTESA – Ky është njëri nga dy rastet për të cilat ekziston aktakuzë dhe seanca të mbajtura gjyqësore. Ish-Ministrja e brendshme dhe dy shefa të Drejtorisë për siguri dhe kundërzbulim akuzohen për shkatërrimin e paligjshëm të sistemeve të monitorimit të komunikimeve që janë përdorur për përgjimin e paligjshëm të komunikimeve, me çka dëmtuan buxhetin e Republikës së Maqedonisë për rreth 10 milion euro.

5. TORTURË - Akuza penale kundër 7 personave që ishin të përfshirë në arrestimin e ish-Ministrit të brendshëm dhe kryetar i partisë “Të bashkuar për Maqedoninë”, Ljube Boshkovski. Gjashtë prej tyre janë pjesëtarë të njësisë policore “Alfat”, ndërsa i shtati është ish-shef i Drejtorisë për siguri dhe kundërzbulim.

6. Thesari - Rasti i keqpërdorimit të ingerencave zyrtare gjatë furnizimit me sistemet e komunikimit. Të dyshuarit janë tre persona udhëheqës në Drejtorinë për siguri dhe kundërzbulim dhe një nga Ministria e brendshme. PSP-ja vlerëson se këta persona e kanë dëmtuar buxhetin për mbi 862 mijë euro për pasurim personal.

7. TOPLIK - I referohet projektit “Qyteti i diellit”, ku ekziston dyshimi se buxheti është dëmtuar me mbi 1.4 milion euro. Keqpërdorimi, sipas PSP-së, ishte kryer në Ministrinë e transportit dhe lidhjeve, kurse të dyshuar janë gjashtë persona të kësaj Ministrie.

8. TENDERËT – PSP-ja dyshon se ka pasur malverzime me tenderin për ndërtimin e ndërtesës së muzeut të VMRO-së. E dyshuara e parë, person udhëheqës në Ministrinë e kulturës, nëpërmjet të telefonit e ka informuar kompaninë Beton - Shtip që të punojë në punët përfundimtare të objektit, edhe pse tenderi do të shpallej më vonë.

9. QËLLIMI - Një rast, përmes të cilit duhet të zgjidhet dilema kush ka përgjuar. PSP-ja dyshon se 10 persona, përfshirë edhe ish zyrtarë të lartë, kanë koordinuar përgjimet masive të kryera nga Drejtoria për siguri dhe kundërzbulim. Prokuroria pretendon se të paktën 4,286 numra telefoni janë monitoruar pa një urdhër gjykatë.

10. TANK - Hapet një hetim ndaj dy personave nga Ministria e brendshme, për të cilët PSP-ja ka dyshime se kanë marrë pjesë në furnizimin e paligjshëm të një “Mercedesi” zyrtar, me vlerë 572,000 euro, për nevojat e ish-kryeministrit Nikola Gruevski.

11. TARIFA - I referohet një procedure lidhur me furnizim publik të softuerit për nevojat e SH.A. ELEM. Të dyshuar janë shtatë persona të kësaj ndërmarrjeje publike, të cilët, sipas PSP-së, duke keqpërdorur kompetencat e tyre, e dëmtuan buxhetin për disa qindra mijëra euro.

12. TRUST - Një rast në të cilin tre persona fizik dhe tre persona juridik dyshohen se kanë bërë keqpërdorime në një procedurë tenderimi për gjurmimin e zgjyrës dhe qymyrit në Suvodol. Hetimi i gjertanishëm ka treguar se një konsorcium me dokumentacion të falsifikuar fitoi një tender, prej të cilit u pajis me pronë të paligjshme prej një miliardë e 60 milion denarësh, ose më shumë se 17 milionë euro. PSP-ja në këtë hetim, më në fund mori një vendim pozitiv për paraburgim të pronarit të konsorciumit, por ai ishte në arrati, deri në mbylljen e raportit.

13. Tabela - Bëhet fjalë për keqpërdorimin e pozitës zyrtare të drejtorit të një shkolle fillore në fshatin Zajas dhe vendimin e tij për të ndërtuar shkollë të re fillore pa respektuar rregulloret ligjore. Në këtë rast, bëhet fjalë për dëm prej rreth 200 mijë eurosh, aq sa vlente kontrata e nënshkruar pa realizuar procedurë të furnizimit publik, për ndërtimin e një shkolle në fshatin Strogovishtë.

14. TREQIND - Në këtë rast, dyshohet se ndihmës ministri në Ministrinë e punëve të brendshme, ka bërë furnizim publik joligjor për 300 automjete për Ministrinë. I dyshuari, në periudhën prej vitit 2008 deri në vitin 2012, ka blerë 300 automjete duke mos i rrespektuar rregulloret ligjore për furnizim publik, me çka ka dëmtuar buxhetin e shtetit për 453 mijë euro.

15. TOTALI – Evazioni fiskal është vepra penale, për të cilën ka dyshime të arsyeshme. I dyshuar është një person, gjegjësisht pronari i disa ndërmarrjeve të marketingut dhe shërbimeve të këshillimit: Total, Media Mak, Total Marketing, Media Centar, i cili në periudhën prej vitit 2008 deri në vitin 2015 ka shmangur pagimin e taksave në vlerë prej rreth 180 mijë eurosh.

16. TIFANI – Përsëri bëhet fjalë për vepër penale evazion fiskal, ku e dyshuara është pronare e kompanive të marketingut dhe shërbimeve të këshillimit: Smart Centar dhe Smart Group. Në këtë rast, gjithashtu, ekziston një dyshim i arsyeshëm se në periudhën prej vitit 2008 deri në vitin 2014, kompanitë dhe pronarja pjesërisht i janë shmangur pagimit të taksave, duke dhënë informata të rrejshme për detyrimet.

2.5 Prokuroria Publike nuk i mbron të drejtat dhe liritë e qytetarëve

Gjatë viteve të kaluara, Komiteti i Helsinkit ka monitoruar vazhdimisht punën e Prokurorisë Publike duke ngritur kallëzime penale dhe duke kërkuar nga Prokuroria Publike që të ngrejë procedura sipas detyrës zyrtare (ex-officio), për shkeljet e të drejtave të qytetarëve, për të cilat raste raportonin mediat.

Në periudhën prej vitit 2013 deri në 2016, Komiteti i Helsinkit ka ngritur ose ka siguruar ndihmë juridike për ngritjen e më shumë se 30 kallëzimeve penale për shkelje të të drejtave të qytetarëve dhe për gjuhë dhe veprime urrejtjeje. Në shumicën e rasteve, nuk ka fare përgjigje për rrjedhën e hetimit nga Prokuroria Publike, ndërsa akuzat tjera janë refuzuar me shpjegimin se vepra penale nuk llogaritet si vepër sipas detyrës zyrtare.

Për më tepër, Komiteti i Helsinkit në mënyrë të përsëritur i bëri thirrje Prokurorisë Publike që, në rastet e shkeljeve masive të të drejtave të qytetarëve, të fillojë procedura sipas detyrës zyrtare, por opinioni nuk u informua kurrë për një hap të tillë.

Gjegjësisht, Prokuroria Publike ishte pasive në kryerjen e hetimeve kur opinioni informohej për shkeljen masive të të drejtave të qytetarëve për shkak të përgjimeve të paligjshme.

Prokuroria Publike nuk ngriti asnjë procedurë për përdorimin e tepruar të forcës nga ana e oficerëve të policisë ndaj qytetarëve që protestuan më 5 maj të vitit të kaluar, edhe pse përdorimi i tepruar i forcës u konstatua edhe nga Ombudsmani dhe organizata të shumta vendore dhe ndërkombëtare, përfshirë edhe Komitetin e Helsinkit. Përkundrazi, Prokuroria Publike nuk ka vepruar për gati 2 vjet për kallëzimin e vetëm penal: maltretim në kryerjen e detyrës, të ngritur nga një person i lënduar nga policia gjatë protestës më 5 maj të vitit 2015, i cili më pas u mbajt në stacionin e policisë për 24 orë.

Prokuroria Publike nuk ngriti asnjë procedurë për kufizimin e pabazuar të së drejtës për protestë të qytetarëve që protestuan paqësisht në vitin 2015 dhe vitin 2016, edhe pse sipas nenit 155 të Kodit Penal, parandalimi ose pengimi i një tubimi publik paraqet vepër penale.

Komiteti i Helsinkit regjistron rregullisht rastet e gjuhës së urrejtjes dhe informon opinionin për këtë, por deri më tani Prokuroria Publike nuk ka ngritur asnjë hetim sipas detyrës zyrtare, për të inicuar verifikimin e përgjegjësisë penale të autorëve

të veprës. Përkundrazi, edhe në rastet kur Komiteti i Helsinkit paraqet kallëzime penale për gjuhë urrejtjeje, prokuroria publike vendos të mos iniciojë procedura, duke lejuar që krime të tilla të përsëriten. Përjashtimi i vetëm pozitiv është procedimi kundër Milenko Nedelkovskit për veprat penale: nxitje të urrejtjes, përçarjes ose intolerancës mbi baza kombëtare, racore, fetare dhe arsye të tjera diskriminuese; Shpërndarje të materialit racist dhe ksenofob përmes sistemit kompjuterik dhe diskriminim racor dhe tjetër. Në këtë rast, Prokuroria e Lartë Publike Shkup, 3 herë e ktheu çështjen në Prokurorinë Themelore Publike Shkup, e cila refuzonte të njohë elemente të gjuhës së urrejtjes dhe të ngrejë akuza për këto vepra penale. Për shkak të kësaj, prokurori publik i cili po vepronte në këtë çështje u ndërrua dhe aktualisht një prokuror tjetër publik po i kryen hetimet.

Prokuroria Publike gjithashtu dështoi edhe në rastin e Tamara Dimovskës, e cila për shkak të parregullësive të mëdha dhe veprimeve të paligjshme të Fondit të Sigurimeve Shëndetësore, vdiq më 09.02.2015.

Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut, pas vdekjes së Tamarës përgatiti dhe ngriti padi penale kundër atyre që janë përgjegjës, për shkak të dyshimit për kryerjen e veprave penale sipas neneve 353 paragrafi 1 dhe 2 të Kodit Penal të Republikës së Maqedonisë, përkatësisht keqpërdorimit të detyrës zyrtare dhe nenit 353-v paragrafi 1 dhe 2 të Kodit Penal të Republikës së Maqedonisë, përkatësisht punë e papërgjegjshme në detyrë.

Padi penale në Prokurorinë Themelore Publike është paraqitur më 19.02.2015 dhe deri më sot, Komiteti nuk ka marrë kurrfarë përgjigje nga Prokuroria Publike Shkup, edhe pse kanë kaluar më shumë se 2 vjet.

Edhe pse me Ligjin e ri për procedurë penale ishte përcaktuar afat kohor për të kryer një procedurë hetimore, konkretisht afat prej gjashtë muajsh, nga data e lëshimit të urdhërit, ky afat nuk është respektuar në asnjë prej çështjeve të Komitetit të Helsinkit. Ky mosveprim vetëm që konfirmon mosfunksionalitetin e prokurorisë publike në mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të qytetarëve.

III. KUSHTETUTA DHE LEGJISLACIONI

1. Gjykata Kushtetuese

Në pesë vitet e kaluara, e posaçërisht nga viti 2013 deri më sot, Gjykata Kushtetuese e Republikës së Maqedonisë ka regjistruar një numër të reduktuar të çështjeve të pranuar dhe të përfunduara, numër të zvogëluar të dispozitave të shfuqizuara dhe të anuluar të ligjeve dhe akteve nënligjore, zvogëlim të numrit të të punësuarve, kurse shuma e mjeteve në buxhetin vjetor, mbeti e njëjtë.

Sipas raporteve vjetore të Gjykatës, numri i çështjeve të pranuar është në rënie të vazhdueshme dhe krahasuar me vitin 2011, kur janë pranuar 236 lëndë, në vitin 2015 janë pranuar 128 raste (-46%). Krahasimi për të njëjtat vite, sa i përket çështjeve të përfunduara është 231/150 (-35%); vendimeve të shfuqizuara / anuluar 32/11 (-66%); dhe kërkesat për mbrojtjen e lirive dhe të drejtave të qytetarëve 23/13 (-43%). Këta tregues negativ flasin për një pasivizim të pazakontë në punën e Gjykatës, zvogëlimin e besimit të qytetarëve, prirje drejt politikave të pushtetit legjislativ dhe ekzekutiv dhe për neglizhencën e shtetit për zhvillimin e bastionit të të drejtave të njeriut dhe përparimin e profesionalizmit të gjyqtarëve kushtetues dhe shërbimit profesional.

Gjatë vitit 2016, Gjykata Kushtetuese kritikohet shpesh, si nga opinioni i gjerë, ashtu edhe nga opinioni profesionist, kurse për punën e Gjykatës shpesh raportohet në media. Në kushte kur është e diskutueshme nëse e gjithë përbërja aktuale e Gjykatës Kushtetuese është nga radhët e juristëve të shquar, zgjedhja e tyre politike, mosrespektimi i praktikës së tyre të mëparshme, mbyllja e seancave për opinionin dhe mospranimi i mendimeve të Komisionit të Venecias, u ngjallën dyshime të arsyeshme se Gjykata në vend të një organi që duhet të mbrojë kushtetutshmërinë dhe ligjshmërinë, u shndërrua në institucion që varet nga pushteti legjislativ dhe ekzekutiv dhe nga partitë politike. Me këtë, në mënyrë serioze është shkelur pavarësia, paanshmëria, kompetenca dhe legjitimiteti i Gjykatës Kushtetuese. Problemet në funksionimin e Gjykatës përmenden gjithashtu edhe në raportet e progresit të Republikës së Maqedonisë të Komisionit Evropian, i cili shpreh vërejtje për përbërjen e Gjykatës, paanshmërinë e Gjykatës si dhe për prolongimin e sjelljes së vendimeve.

Në Seancën e katërt të Gjykatës Kushtetuese, të mbajtur më 24 shkurt, Gjykata mori vendim për ngritjen e procedurës për vlerësimin e kushtetutshmërisë së Ligjit për Ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për falje (“Gazeta Zyrtare e RM-së nr. 12/2009”). Në seancën e 7-të të Gjykatës Kushtetuese, të mbajtur më 16 Mars, pati shfuqizim të dispozitave të ligjit, duke përfshirë edhe dispozitën me të cilën verifikohet se nuk mund të falen persona të gjykuar për vepra penale lidhur me zgjedhjet. Para marrjes së vendimit, Komiteti i Helsinkit i bëri thirrje Gjykatës Kushtetuese të pozicionohet mbi interesat partiake dhe individuale dhe të sjellë vendim me të cilin nuk do të verifikojë që ligji është jokushtetues dhe nuk do ta shfuqizojë. Është simptomatik fakti që Gjykata Kushtetuese vendosi se ekziston nevoja për vlerësimin e kushtetutshmërisë së këtij ligji, veçanërisht kur merret parasysh fakti se iniciativa për ta kundërshtuar atë ligj u ngrit në fillim të shkurtit, menjëherë pas hapjes së çështjes “Titanik” nga ana e Prokurorisë speciale publike. Në rastin “Titanik” në cilësinë e të dyshuarve për mashtrim zgjedhor ndodheshin edhe ish-ministrat Mile Janakievski dhe Gordana Jankulovska, si dhe persona të tjerë pranë koalicionit qeverisës. Shpejtësia e veprimit, e treguar nga Gjykata Kushtetuese në këtë rast (40 ditë nga iniciativa e paraqitur deri në vendimin përfundimtar) është shembull i vetëm i veprimit të shpejtë lidhur me ndonjë iniciativë të caktuar, me çka haptazi doli në shesh roli i saj si një instrument për mbrojtjen e interesave partiake të një partie politike të koalicionit qeverisës.

2. Ligji për Ndhimë Juridike Falas

Ligji për Ndhimë Juridike Falas është zgjidhja e parë ligjore për realizimin e të drejtës së garantuar kushtetuese për barazi (neni 9) që proklamon barazi ndërmjet qytetarëve pavarësisht nga gjinia, raca, ngjyra e lëkurës, prejardhja kombëtare dhe sociale, bindjet politike dhe fetare, statusi shoqëror dhe pronësor, nga njëra anë, dhe barazia e qytetarëve para Kushtetutës dhe ligjeve, nga ana tjetër. Kjo dispozitë e Kushtetutës i referohet nevojës për sigurimin e qasjes së barabartë në drejtësi për të gjithë qytetarët, përfshirë qytetarët që hyjnë në kategori të prekura, jetesa e të cilëve është vështirësuar si rezultat i drejtpërdrejtë i pozitës financiare në të cilën gjenden.

Në sistemin e ndihmës juridike falas janë identifikuar problemet juridike dhe

dobësite e vetë ligjit për ndihmë falas, të cilat e kufizojnë të drejtën e qasjes së barabartë për drejtësi.

Të drejtë për ndihmë juridike falas, kanë persona të përcaktuar në Ligj, të cilët, duke pasur parasysh pozitën e tyre materiale, nuk do të kishin mundësi t'i realizojnë të drejtat e garantuara me Kushtetutë dhe me Ligj, pa rrezikuar ekzistencën vetanake si dhe ekzistencën e anëtarëve të familjes, me të cilët jetojnë në një bashkësi familjare. Kërkesa për ndihmë juridike falas, në përputhje me dispozitat e Ligjit për Ndihmë Falas, miratohet në të gjitha procedurat gjyqësore dhe administrative, nëse në këtë mënyrë zgjidhet një çështje me interes për kërkuesin. Megjithatë, ligji kufizon mundësinë për të kërkuar ndihmë juridike në fusha të tjera, përveç në ato fusha që janë të theksuara në ligj, siç janë: të drejtat në fushën e sigurimit social, shëndetësor, pensional dhe invalidor, në marrëdhëniet e punës, mbrojtjes së fëmijëve, viktimave të dhunës në familje, mbrojtje të viktimave të veprave penale, mbrojtje të viktimave të trafikimit me njerëz, njohja e të drejtës së azilit dhe çështjet pronësore – juridike.

Një nga mangësitë kryesore të këtij Ligji, është prona maksimale e parashikuar që duhet ta ketë kërkuesi. Si përfitues mund të paraqiten vetëm një kategori e vogël e personave, përkatësisht persona që jetojnë në kushte të mjerimit të madh. Ligji aktual, në vend që të promovojë përparimin e të drejtave për barazi të qytetarëve, sjell qasje të pabarabartë në drejtësi dhe i anashkalon qytetarët e varfër në Republikën e Maqedonisë, me çka bëhet shkelje e parimit themelor të ligjit. Gjegjësisht, pasuria e paluajtshme (banesa, shtëpia) në të cilën jeton kërkuesi dhe familja e tij, kanë një rëndësi të veçantë për zbatimin e këtij ligji. Para së gjithash, hapësira minimale e banimit duhet të përjashtohet nga prona që do t'i nënshtrohet përcaktimit dhe vlerësimit nga autoritetet kompetente. Në pjesën e pronës së lejuar, në përputhje me numrin e pagave mesatare, duhet të harmonizohet vetë teksti ligjor, sepse baza për pagat bruto lejohet vetëm në rast të posedimit të automjetit, por është e paqartë për pronën tjetër të lejuar, të cilën autoritetet kompetente në mënyrë arbitrare e llogarisin në pagat mesatare-neto.

Termi “pronë” e kërkuesit të ndihmës juridike falas, nënkupton tërë pasurinë e luajtshme dhe të paluajtshme, të drejtat e pronës, shumën e parave të gatshme në valutë të vendit dhe të huaj, para në llogari personale apo librezë kursimi, dhuratë, letra me vlerë, aksione, pjesë në kapital dhe pasuri tjetër të parashtruesit të

kërkesës ose të anëtarëve të rritur të bashkësisë së tij familjare, në vend ose jashtë vendit.

Lidhur me përkufizimin e termit “anëtarë të familjes” në Ligjin për Ndhimë Juridike Falas, rrethi familjar është përfshirë shumë gjerësisht, sepse në përputhje me brezin e katërt të parashikuar, ky rreth përfshin stërgjysh, stërgjyshe dhe stërnipër, gjë që mund të paraqesë problem në praktikë, nëse merret parasysh që të ardhurat dhe prona e kërkuesit, vlerësohen në nivelin e tërë pronës dhe të ardhurave totale të bashkësisë familjare në të cilin jeton aplikuesi.

Krahas kësaj mangësie, praktika tregon se nuk merret gjithmonë parasysh urgjenca e procedurës për zgjidhjen e të drejtës për ndihmë juridike falas. Kjo i dedikohet kryesisht centralizimit të vendimmarrjes, përkatësisht Ministria e drejtësisë është e detyruar të vendosë për territorin e të gjithë vendit, si dhe “komunikimit të dobët” midis institucioneve shtetërore, të cilat duhet të lëshojnë prova për statusin pronësor të kërkuesit. Kështu, përkundër 20 ditëve të parapara si një afat ligjor brenda të cilit Ministria vendos të miratojë ose refuzojë kërkesën për ndihmë juridike falas, në praktikë kohëzgjatja reale e kësaj procedure zgjat 40-60 ditë, me çka tejkalohen afatet e Ligjit për Procedurë Civile, Ligjit për procedurë të përgjithshme administrative, Ligjit për Kontestet Administrative dhe Ligjit për Kontestet e Punës, në të cilat është përcaktuar afat prej 8 ditësh, përkatësisht prej 15 deri në 30 ditë për padi apo ankesë në organet kompetente ose gjykatat në një procedurë gjyqësore apo administrative. Viktimat e dhunës në familje, për shkak të urgjencës së situatës në të cilën ndodhen, zakonisht vendosin të mos kërkojnë ndihmë juridike falas, mu për shkak të afateve brenda të cilave merren vendimet. Për këto arsye, është e nevojshme që Ligji për Ndhimë Juridike Falas urgjentisht të ndryshohet dhe të harmonizohet me ligjet e tjera që lidhen me ndihmën juridike falas dhe ndërmjet institucioneve të vendoset një sistem më efikas dhe më i shpejtë për këmbimin e të dhënave për aplikuesit.

Kur bëhet fjalë për fitimin e të drejtës për ndihmë juridike falas për personat me pension më të ulët, e që jetojnë në një bashkësi familjare me dy ose më shumë persona që varen nga ai, përsëri vjen në shprehje natyra kufizuese e ligjit për aplikantët që kanë pension më të ulët dhe që në vend me dy ose më shumë persona, jetojnë me një person të varur nga ai, kështu që nuk i plotësojnë kriteret e ashpra të parashikuara në ligj. Në aspekt të mangësive terminologjike dhe konceptuale, mungon një përcaktim i

qartë se cili qytetar konsiderohet si “prind i vetëm” që realizon të drejtën e ndihmës për fëmijë, që është një nga kriteret për realizimin e të drejtës për ndihmë juridike falas, për çka në praktikë mund të vërehen interpretime të ndryshme të këtij termi, e që nga ana tjetër kontribuon në rritjen e pasigurisë ligjore.

Ndërgjegjësimi i qytetarëve për Ligjin për Ndhimën Juridike Falas është në një nivel të palakmueshëm. Me dispozitën ligjore për ndalimin e reklamimit, në përputhje me Ligjin për Ndhimën Falas, shoqatave të autorizuara për ofrimin e ndihmës juridike paraprake u ndalohej reklamimi për dhënie paraprake të ndihmës juridike. Reklamimi i palejuar është baza për heqjen e autorizimit për dhënie të ndihmës juridike. Kjo dispozitë ligjore është e palogjikshme për arsye se vetë shoqatat janë organizata jofitimprurëse, dhe jo subjekte që do të bënin më shumë fitim me reklama. Kjo dispozitë i shkakton pasoja negative vetë qëllimit të ligjit.

Komiteti i Helsinkit mirëpret nismën për hartimin e një Ligji të ri për ndihmë juridike falas, me shpresën se në të ardhmen do të mundësojë realizimin e qëllimit të vetë ligjit dhe do të sigurojë qasje të barabartë në drejtësi për të gjithë qytetarët e Republikës së Maqedonisë.

3. Presidenti i Republikës së Maqedonisë

Më 12 prill, Presidenti i Republikës së Maqedonisë në mënyrë kolektive fali 57 autorë të dyshuar të veprave penale, për të cilët ishin dorëzuar kallëzime penale ose ishin ngritur procedura penale. Shumica e të dyshuarve ishin nën hetim nga PSP-ja. Me këtë akt, Presidenti shkoi përtej kompetencave të veta kushtetuese dhe ligjore dhe kështu kreu veprë penale keqpërdorim të pozitës zyrtare, neni 353 i Kodit Penal të Republikës së Maqedonisë.

Gjegjësisht, qëndrimin dhe vendimet për falje, Presidenti i mori pa bazë ligjore, duke pasur parasysh faktin se neni 11 i Ligjit për amnisti, të cilit ai iu referua, ishte shfuqizuar dhe nuk është pjesë përbërëse e rendit juridik të Republikës së Maqedonisë. Me këtë akt, Presidenti padyshim i tejkaloi kompetencat e tij, sepse nën pretekstin e faljes, që është një akt i parashikuar për raste individuale, si korrigjim i drejtësisë në raste specifike dhe veçanërisht të justifikuara, Presidenti në thelb dhe de facto për vehte, uzurpoi kompetenca për një falje grupore dhe kolektive, për një

numër të madh të veprave penale, duke shkelur kështu autoritetin që Kushtetuta, për shkak të seriozitetit, e parasheh si të drejtë ekskluzive të Kuvendit të Republikës së Maqedonisë.

Me këtë, Presidenti e vuri veten mbi të drejtën, mbi Parlamentin dhe mbi marrëveshjen politike të Përzhinos, me çka në thelb shfuqizoi kompetencat e PSP-së, si një organ i pranuar konsensualisht, kompetent për të ndjekur veprat penale lidhur me bisedat e përgjuara në mënyrë të paligjshme. Ky është ndoshta shembulli i vetëm në histori ku një kryetar shteti ka falur shkelje masive dhe të organizuar të të drejtave dhe lirive të njeriut, përfshirë rastet e shkeljes së të drejtës kushtetuese për lirinë në zgjedhje, shkeljes së privatësisë, ka amnistuar korrupsionin dhe keqpërdorime të tjera të elitës politike, të cekura më parë në një seri raportesh të besueshme dhe serioze vendore dhe ndërkombëtare, të një varg organizatave qeveritare dhe joqeveritare.

Duke penguar drejtësinë penale në një numër veprimesh korruptive të përfshira me faljen, Presidenti gjithashtu shkeli detyrimet ndërkombëtare të shtetit për të parandaluar dhe ndjekur penalisht korrupsionin, pastrimin e parave, duke shkelur kështu dispozitat e Konventës së Palermos. Nxitimi dhe mosqëndrueshmëria e vendimeve, u pa qartazi në rastet ku u falën persona që fare nuk ishin të dyshuar në procedurat penale, kështu që u falën persona, tek të cilët është bërë vetëm kontroll lidhur me persona të tjerë të dyshuar, kurse u falën edhe persona për të cilët ka vetëm kallëzime penale, por nuk janë proceduar penalisht.

Më 27 maj, Presidenti vendosi të anulojë faljen për 22 persona, siç deklaroi ai, të gjithë persona të ekspozuar politikisht. Pas presionit të madh nga opinioni vendas dhe ndërkombëtar, Presidenti më 6 qershor vendosi të tërheq plotësisht vendimin për amnisti - lirim nga ndjekja penale pa ngritje të procedurës, vendim të cilin e solli më 12 prill.

IV. INSTITUCIONET E MBYLLURA DHE MALTRETIMI

Edhe në vitin 2016, personat e gjykuar, të cilët kontaktuan me Komitetin e Helsinkit, theksuan nivelin e lartë të korrupsionit në mesin e shërbimeve të burgjeve dhe të burgosurve. Sipas të dënuarve, në burgjet mund të blihet gjithçka, që nga celularët, droga, liri me kusht dhe akomodimi më i mirë në burg. Dhuna e ushtruar nga shërbimet e burgut vazhdon, në formën e shuplakave, grushtave, shqelmave e goditjeve me shkop në trup. Dhuna përdoret si një dënim për posedimin e objekteve të paligjshme, si një mjet për disiplinim ose për zgjidhjen e dhunës midis të burgosurve. Gjithashtu është raportuar edhe për trajtim racist të burgosurve të përkatësisë etnike Rome.

1. Mbrojtja shëndetësore në burgje

Gjatë vitit 2016, disa persona të dënuar që vuanin dënim me burg, iu drejtuan Komitetit të Helsinkit, nëpërmjet te telefonit apo me letra, duke deklaruar se kishin nevojë për ndihmë në realizimin e të drejtës së tyre për mbrojtje shëndetësore, gjë që është në përputhje me Nenin 124 dhe nenin 129, paragrafët 1 dhe 2 të Ligjit për Ekzekutimin e Sanksioneve. Këta persona, për shkak të gjendjes së dobët shëndetësore, me iniciativën e tyre dhe me shpenzimet e veta, kërkojnë nga shërbimet e burgut të dërgohen për trajtim mjekësor jashtë burgut ku e vuajnë dënimin. Në vitin 2016 Komiteti i Helsinkit konstatoi se autoritetet e burgut vonojnë në mënyrë të panevojshme procesin e mjekimit të të dënuarve dhe dërgimin e tyre për trajtim mjekësor, një situatë që është e dëmshme për shëndetin e këtyre personave, duke shkelur kështu të drejtën e tyre të garantuar ligjërisht për kujdes shëndetësor.

2. Rastet e vdekjeve në burgje

Gjatë vitit 2016, por edhe në fillim të vitit 2017, niveli i vdekjeve ishte veçanërisht shqetësues. Për një periudhë prej 15 muajsh, vdiqën 13 persona që vuanin dënimin me burg, shumica dërmuese e tyre në Burgun e Idrizovës.

Rastet e vdekjeve u regjistruan në burgje, në veturat e ambulancave gjatë rrugës për në spital, ose menjëherë pas shtrimit në spital. Thuaja në të gjitha rastet, Drejtoria për ekzekutimin e sanksioneve dhe burgjeve raportoi se vdekjet ishin rezultat i mbi-dozimit me substanca narkotike ose ilaçe. Përkundër faktit se prokuroritë publike urdhëronin autopsi, rezultatet nuk bëheshin publike, gjë që vetëm sa intensifikon dyshimet se shkak mund të jetë neglizhenca e institucioneve të burgut, por edhe dhuna në burgje. Komiteti i Helsinkit konsideron se arsyeja kryesore për shkallën e lartë të vdekshmërisë është kujdesi joadekuat mjekësor, veçanërisht për personat që kanë nevojë për kujdes të specializuar mjekësor. Të dënuarit trajtohen vetëm nga mjekë të përgjithshëm dhe shpesh ka mungesë të terapisë për të sëmurët kronikë, të cilët janë të detyruar të gjinden vetë. Përdorimi i ilaçeve zëvendësuese, vetëm e përkeqëson situatën. Në burgjet thuajse fare nuk trajtohen personat e varur nga droga dhe mjete të tjera narkotike.

3. Ndhimja juridike

Një numër i madh i të dënuarve që e kontaktuan Komitetin e Helsinkit në vitin 2016, u ankuan për mosfunksionimin e shërbimeve juridike në institucionet e vuajtjes së dënimit. Disa nga të dënuarit që kërkuan ndihmë juridike falas nga Komiteti, nuk ishin fare në dijeni për mundësinë e marrjes së ndihmës juridike në vetë burgjet. Megjithëse shërbimi juridik i Komitetit të Helsinkit i këshilloi ata për të drejtat e tyre, që përmes ankesave dhe lutjeve t'u drejtohen drejtorëve të burgjeve, të gjithë, thuaja pa përjashtim, deklarorin se nuk i besonin sistemit dhe se nëse do ta bënë këtë, vetëm se do ta ndërlikonin edhe më tepër, situatën edhe ashtu të vështirë në burg.

Përballë këtij mosbesimi, Komiteti i Helsinkit i udhëzonte të dënuarit të dërgojnë lutje me shkrim me kërkesë për vizitë nga përfaqësuesit e Komitetit. Shqetësim të veçantë paraqet fakti se edhe pas një rekomandimi të tillë, të cilin të dënuarit e pranorin, disa nga lutjet e tyre nuk arrinin fare në zyrën e Komitetit të Helsinkit. Pas arritjes së lutjeve, Komiteti i Helsinkit gjithmonë dërgonte kërkesë për vizitë të të dënuarve, por kërkesat e Komitetit rrefuzoheshin në mënyrë sistematike nga Drejtoria për Ekzekutimin e Sanksioneve.

4. Rikonstruimi i burgjeve

Me një hua prej 52 milionë eurosh, të siguruar në vitin 2009 nga Banka për rindërtim dhe zhvillim pranë Këshillit të Evropës, fondet IPA dhe Qeveria e Norvegjisë, Ministria e drejtësisë duhej të fillonte projektin për rikonstruimin dhe sanimin e burgjeve në të gjithë vendin. Ishte planifikuar një sanim i plotë, si dhe prishja e objekteve ekzistuese dhe ndërtimi i objekteve të reja me kapacitet më të madh. Përmes këtij projekti, u premtua një pamje krejtësisht e re e shtëpisë ndëshkuese rehabilituese "Idrizovë", Burgut të Shkupit, shtëpisë edukative rehabilituese në Tetovë dhe përfundim i aktiviteteve ndërtimore në burgun e ri në Kumanovë.

Megjithëse kanë kaluar më shumë se 8 vjet nga sigurimi i kredive të favorshme, deri në vitin 2017, puna në terren nuk ka përfunduar për asnjë institucion. Ministria e drejtësisë në një procedurë jashtëzakonisht burokratike dhe të ngadaltë, lidhur me projektet teknike, elaboratet dhe tenderët, nuk arriti të përdorë fondet e siguruar. Edhe pse ky projekt duheshte të fillojë më së voni në vitin 2011 dhe pjesa më e madhe e rikonstruimeve të përfundojë deri në vitin 2015, asnjë projekt nuk kishte përfunduar plotësisht deri në përfundimin e këtij raporti. Kjo situatë flet për joprofessionalizmin e Ministrisë së Drejtësisë dhe neglizhencën e Qeverisë për personat e dënuar, për çka mijëra të dënuar po qëndrojnë në kushte substandarde të jetesës. Ndërkohë, mbipopullimi në burgje po rritet dhe në vitin 2016 arriti rreth 160%. Me këtë pasivitet, Republika e Maqedonisë jo vetëm që nuk përmbushi rekomandimet e Komitetit për Parandalimin e Torturës pranë Këshillit të Evropës, por gjithashtu përkeqësoi edhe më tepër të drejtat e njeriut të personave që vuajnë dënimin me burg.

5. Mekanizmat e mbikëqyrjes

Mekanizmat e mbikëqyrjes janë vetëm pjesërisht funksionale dhe nuk mund të konsiderohen të pavarura. Me hyrjen në fuqi të Protokollit Opsional të Konventës Kundër Torturës dhe keqtrajtimeve tjera mizore, çnjerëzore, poshtëruese ose dënimit, në vitin 2009, Ombudsmani u emërua si Mekanizmi Kombëtar Parandalues i cili filloi të ushtrojë kompetencat e veta në vitin 2011. Efektiviteti i këtij mekanizmi,

megjithëse është rritur gjatë vitit 2016, është ende i pakënaqshëm, veçanërisht për shkak të mungesës së kuadrit profesional dhe pjesërisht për shkak të mospjesëmarrjes së organizatave qytetare, e cila, megjithëse është e mundur, zbatohet rrallë në praktikë.

Përveç Ombudsmanit, indikacionet e të cilit nuk janë obligative, nuk ka mekanizma për kontroll të pavarur as të burgjeve dhe as të Drejtorisë për zbatimin e Sanksioneve. Komisioni Shtetëror për Mbikëqyrjen e Institucioneve ndëshkuese - rehabilituese dhe edukative - rehabilituese, vendimet e të cilit do të ishin obligative për të gjithë ata, të cilëve u referohet, është formuar vetëm në letër. Nuk është aktiv dhe nuk i realizon kompetencat e veta. Mbikëqyrja nga ana e gjykatësve për zbatimin e sanksioneve është gjithashtu joekzistuese. Drejtoria vazhdimisht i refuzon OJQ-të dhe mediat të vizitojnë burgjet dhe të flasin me personat e gjykuar. Me përjashtim të Avokatit të Popullit, në Maqedoni nuk ka mekanizma të tjerë të përhershëm për mbikëqyrjen e burgjeve dhe Drejtorisë për zbatimin e Sanksioneve.

6. Institucioni publik Enti Special Demir Kapi

Gjatë vitit 2016, përfaqësues të Komitetit të Helsinkit vizituan Entin Special në Demir Kapi dhe përgatitën një raport mbi gjendjen e këtij institucioni dhe të të mbrojturve të vendosur në institucion. Njëri nga qëllimet e raportit është të rishikohet se cilat nga masat dhe aktivitetet e propozuara të Strategjisë së Deinstitutionalizimit janë ndërmarrë dhe zbatuar nga Enti Special në Demir Kapi dhe si rezultat i kësaj, cilat nga problemet e përmendura më parë janë kapërcyer².

Gjendja e Entit special dhe e personave të vendosur në të, është më shumë se alarmanante. Të gjitha departamentet janë në gjendje të keqe dhe nuk plotësojnë kushtet minimale të jetesës. Pjesa e jashtme e ndërtesave është në gjendje të keqe, muret janë të gërryera dhe fasada ka rënë në shumë vende. Dhomat janë plot lagështi dhe myk. Enti special akoma nuk ka gjinekolog ose një karrige gjinekologjike të aksesueshme për personat me aftësi të kufizuara fizike, nuk ndahen mjete kontraceptive e as nuk u ofrohet arsimim seksual. Numri i defektologëve nuk korrespondon me numrin e të mbrojturve.

² Raportin e plotë për gjendjen në të cilën ndodhet enti special Demir Kapi dhe gjendjen e personave të vendosur aty, mund ta lexoni në linkun në vijim: <http://mhc.org.mk/>

Një shqetësim të veçantë paraqesin të dhënat, të kontrolluara në Librin e rasteve të vdekjeve, se nga viti 1993 deri në 5 Shkurt të vitit 2016, në Entin special kanë vdekur 375 persona.

VITI	RASTET E VDEKJES	VITI	RASTET E VDEKJES	VITI	RASTET E VDEKJES	GJITHSEJ
1993	46	2001	17	2009	8	375
1994	25	2002	13	2010	13	
1995	18	2003	10	2011	7	
1996	31	2004	12	2012	9	
1997	31	2005	11	2013	9	
1998	22	2006	11	2014	9	
1999	21	2007	9	2015	12	
2000	19	2008	9	2016	3	

Pjesa dërrmuese e rasteve të vdekjeve rezulton të jetë nga sëmundjet pulmonare. Numri më i madh i të mbrojturve që kanë vdekur nga sëmundjet pulmonare, janë persona të palëvizshëm, me të meta të thella intelektuale. Mjeku i përgjithshëm, i angazhuar herë pas here nga Ministria e punës dhe politikës sociale nuk mund të veprojë si një mjek i familjes, do të thotë nuk mund të jep udhëzime mjekësore për trajtimin e të mbrojturve. Përveç faktit se nuk ka mjek të përgjithshëm, të angazhuar vazhdimisht, enti special ende nuk ka stomatolog. Arsyeja për këtë është se Enti Special Demir Kapi nuk funksionon brenda sistemit të rregullt shëndetësor, do

të thotë nuk është pjesë e Ministrisë së shëndetësisë. Si pasojë, një numër i madh i të mbrojturve nuk mund t'i realizojnë të drejtat e sigurimit shëndetësor, përkatësisht në spitalet e përgjithshme dërgohen vetëm në situata të rrezikshme për jetën.

Është e qartë se deinstitutionalizimi nuk ka filluar në këtë institucion dhe është e domosdoshme të merren masa më aktive për realizimin e tij.

7. Torturimi dhe trajtimi çnjerëzor

Gjatë marsit 2016, Komiteti i Helsinkit dërgoi 49 kërkesa për informatë në lidhje me rastet e regjistruara në të cilat prokuroritë themelore publike dhe gjykatat vepruan për veprat penale Torturë dhe trajtim ose dënim tjetër mizor, çnjerëzor ose degradues (për çka është i paraparë dënim me burg prej 3 deri në 20 vjet) dhe maltretim në kryerjen e detyrës (për çka është paraparë dënim me burg prej 1 deri në 5 vjet) për periudhën 2009 - 2015. U morrën informata kthyesë prej 21 gjykatave (nga gjithsej 26) dhe prej 20 prokurorive themelore publike (nga gjithsej 23). Sipas përgjigjeve të gjykatave, gjatë periudhës gjashtëvjeçare, ato kanë vepruar për 22 çështje në lidhje me torturat dhe 56 raste në lidhje me maltretim.

Për vepra penale torturë, nuk ka pasur asnjë vendim me të cilin dikush është dënuar me burg. Ka pasur vetëm tetë vendime për dënime me kusht, si masë alternative. Lidhur me veprën penale maltretim në kryerjen e detyrës, është shqiptuar vetëm një vendim me dënim me burg (gjashtë muaj) dhe 16 vendime me dënim me kusht. Prokuroritë Themelore Publike trajtuan 32 raste të torturave. Vetëm për shtatë prej tyre pati hetime dhe akuza. Prokuroritë vepruan në 138 raste për maltretim gjatë kryerjes së detyrës, hetime ka pasur për 30 raste, kurse akuza u ngritën në 22 raste.


V. DISKRIMINIMI

1.Hyrje

Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut monitoroi në mënyrë aktive situatën me diskriminimin në Republikën e Maqedonisë gjatë vitit 2016, duke vepruar në rastet e raportuara të diskriminimit dhe procedurat para organeve të barazisë dhe gjykatave, si dhe përmes monitorimit të mediave dhe rrjeteve sociale dhe monitorimit të procedurave gjyqësore.


Duke vepruar në bazë të ankesave të paraqitura nga qytetarët dhe duke monitoruar situatën në shoqëri dhe në media në periudhën maj - nëntor 2016, Komiteti konstatoi se shumica e tyre kishin të bëjnë me diskriminimin në bazë të përkatësisë etnike, gjinore, politike, aftësisë së kufizuar dhe religjionit.

Paraqitje tabelare e bazave të diskriminimit




Sa i përket sferave në të cilat është më i shprehur, të dhënat tregojnë se numri më i madh i rasteve të diskriminimit është vërejtur në sferën e marrëdhënieve të punës, në arsim, shëndetësi dhe qasje në të mira materiale dhe shërbime.

Paraqitje tabelare e sferave të diskriminimit



Sipas monitorimit të Komitetit të Helsinkit dhe informatave të marra nga shoqatat qytetare dhe nga Ombudsmani³, në vitin 2016 u zhvilluan gjithsej 57 procedura gjyqësore, nga të cilat deri në fund të vitit 2016 përfunduan 10 procedura gjyqësore, nga të cilat 4 ishin pozitive dhe 4 negative.

Sipas monitorimit lidhur me reagimet në media për rastet e diskriminimit, mund të konstatohet se institucionet janë akoma pasive ndaj gjykimit të diskriminimit dhe ngritjes së vetëdijes për diskriminimin ekzistues, kurse shoqatat qytetare janë më aktivet në këtë drejtim.



Raste individuale të diskriminimit para organeve të barazisë

³ Nga data 01.06.2016 Komiteti i Helsinkit filloi me përgatitjen e informatorëve mujorë për diskriminim që përbajnë informata nga shoqatat e qytetarëve dhe Ombudsmani, për rastet e raportuara të diskriminimit dhe procedurat e filluara për mbrojtje nga diskriminimi.

2. Diskriminim i verifikuar mbi personat e verbër nga ana e bankave

Komiteti i Helsinkit, së bashku me anëtarët e Rrjetit për Mbrojtje nga Diskriminimi, Lidhja Kombëtare e personave të verbër të Republikës së Maqedonisë dhe Lidhja Kombëtare e invalidëve civilë të luftës së Maqedonisë, në prill të vitit 2013 paraqitën ankesë në Komisionin për Mbrojtje nga Diskriminimi kundër të gjitha bankave në Republikën e Maqedonisë me qëllim të verifikimit të diskriminimit që bëhet ndaj këtij grupi njerëzish. Trajtimi i pabarabartë i referohet shfrytëzimit të shërbimeve dhe produkteve bankare që kërkojnë nënshkrimin e shfrytëzuesit, me ç'rast bankat nuk e pranojnë nënshkrimin e personave të verbër, nuk lejojnë përdorimin e faksimilit dhe i detyrojnë ata të autorizojnë një palë të tretë që do të nënshkruante në emër të tyre dhe për llogarinë e tyre. Personat e verbër përballen gjithashtu me probleme edhe gjatë përdorimit të online banking, për shkak të rregullave të brendshme të bankave (përdorimi i tokenave, kodeve dhe mjeteve të tjera të sigurisë, të cilat personat e verbër nuk janë në gjendje t'i përdorin). Për më tepër, bankat nuk ofrojnë përdorimin e teknologjisë ndihmëse, siç janë për shembull bankomat zëri, alfabeti Braj, zgjidhje softuerësh për qasje në shërbimet elektronike, etj.

Për këto arsye, Komisioni për Mbrojtje nga Diskriminimi morri mendim pozitiv me të cilin verifikoi diskriminimin e drejtpërdrejtë dhe të zgjatur në bazë të aftësisë së kufizuar fizike mbi të verbërit nga bankat. Komisioni rekomandoi bankat të mos kërkojnë që një person i autorizuar të veprojë në emër të të verbërve dhe personave me të meta në shikim, por të krijojnë kushte për nënshkrim personal dhe faksimil. Komisioni rekomandoi që secila bankë të bëjë një përshtatje të arsyeshme ndaj nevojave specifike të këtyre personave, si në degët e saj ashtu edhe në internet. Lidhur me kontrollin e punës së bankave, Komisioni i rekomandoi Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë, si institucion përgjegjës për mbikëqyrjen e veprimtarisë së bankave, të përforcojë kontrollin me qëllim që për personat e verbër dhe me të meta në shikim të arrihet qasje e barabartë në shërbimet dhe produktet e bankave.

3. Diskriminimi dhe profilizimi racor në vendkalimet kufitare dhe kufizimi i të drejtës për lëvizje të lirë

Gjatë vitit 2016, vazhdoi diskriminimi dhe profilizimi racor në pikat kufitare si dhe kufizimi i të drejtës për lëvizje të lirë. Komitetit të Helsinkit për të Drejtat e Njeriut iu drejtua një palë e cila kërkoi ndihmë juridike për shkak të kufizimit të së drejtës për të lëvizur dhe largim të lirë nga vendi dhe për shkak të diskriminimit në bazë të përkatësisë etnike të supozuar nga oficerët e policisë që punojnë në pikat kufitare. Rasti ka ndodhur kur pala ka dashur të kalojë pikëkalimin kufitar në Aeroportin “Aleksandri i Madh” dhe të udhëtojë për në Zvicër. Oficeri i policisë kufitare i cili bëri kontrollin e pasaportës, i ka thënë palës se nuk mund të kalojë kufirin, sepse përveç që nuk kishte para, në vitin 2014 ka kërkuar azil në Norvegji dhe kështu ka keqpërdorur regjimin pa viza të Republikës së Maqedonisë. Sipas oficerit të policisë, pala ka dashur përsëri të kërkojë azil, këtë herë në Zvicër, dhe për këtë arsye nuk i është lejuar të kalojë kufirin shtetëror. Pas kthimit të pasaportës, pala ka vënë re se në pasaportë janë shënuar dy vija. Kjo sjellje diskriminuese e oficerëve të policisë në pikën kufitare në Aeroportin “Aleksandri i Madh” ngjall dyshime të arsyeshme se pala ka qenë viktimë e diskriminimit të drejtpërdrejtë në bazë të origjinës së supozuar etnike, do të thotë oficerët e policisë nuk e lejuan atë të kalonte kalimin kufitar, duke e konsideruar rome, për shkak të emrit dhe mbiemrit.

4. Diskriminim në bazë të statusit martesor e familjar dhe religjionit në tekstin shkollor “Shoqëri” për klasën e katërt

Rrjeti për Mbrojtje nga Diskriminimi, i koordinuar nga Komiteti i Helsinkit, u ofroi ndihmë juridike 42 prindërve për të paraqitur një ankesë tek Avokati i Popullit dhe Inspektorati Shtetëror i Arsimit për verifikimin e diskriminimit të drejtpërdrejtë në bazë të statusit martesor, familjar dhe religjionit kundër komisionit recenzent në tekstin shkollor “Shoqëri” dhe Ministrisë së arsimit dhe shkencës, për shkak të teksteve diskriminuese në bazë të statusit martesor e familjar, por edhe në bazë të religjionit në tekstin shkollor.

Ankesës i parapriu një reagim i disa prindërve për një ushtrim në tekstin shkollor, ku nxënësve u kërkohet të ngjisnin një fotografi të martesës së prindërve, e madje edhe të tregojnë se a kanë lidhur kurorë në kishë apo në zyrën civile, gjë që është

shumë shqetësuese dhe stigmatizuese për fëmijë dhe prindër që jetojnë në familje jotradicionale. Një ushtrim dhe tekst i tillë nënkupton diskriminim ndaj fëmijëve që jetojnë në familje me një prind, që mund të rezultojnë nga divorci i bashkëshortëve, vdekje e prindit, fëmijëve që jetojnë në familje me të afërm të tjerë, ndaj prindërve që jetojnë në bashkësi jashtëmartesore, ose prindërve që kanë lidhur martesë civile, por nuk kanë bërë dasëm. Përveç ushtrimit në fjalë, edhe pjesë të tjera të librit shkollor ku flitet për martesën dhe familjen, kanë përmbajtje që përjashtojnë dhe stigmatizojnë familjet jotradicionale. Kjo përmbajtje në librat shkollorë, përveç që diskriminon dhe stigmatizon grupe të tëra të fëmijëve dhe prindërve dhe ndikon negativisht në zhvillimin e fëmijëve në familjet jo konvencionale, gjithashtu parandalon qasjen në informata të sakta dhe relevante për çdo nxënës nëpërmjet të ndërtimit të një imazhi përjashtues se çfarë do të thotë një familje “normale”. Kështu pamundësohet fitimi i njohurive për dallimet dhe ndërtohen stereotipe negative tek nxënësit, që në klasën e katërt.

5. Diskriminimi ndaj personave transgjinorë

Në qershor 2016, Komisioni për Mbrojtje nga Diskriminimi solli mendim që përcakton diskriminimin e drejtpërdrejtë në bazë të identitetit gjinor, për shkak të hyrjes së ndaluar në objekt që ofron shërbime publike - pishinë, do të thotë qasje e kufizuar në shërbime për shkak të identitetit gjinor. Ankesa është paraqitur nga vetë pala, kurse ndihma juridike ishte siguruar nga Komiteti i Helsinkit. Megjithëse në mendimin e Komisionit definohet se diskriminimi është në bazë të gjinisë, në arsyetimin e mendimit konstatohet se identiteti gjinor i viktimës ishte faktori kryesor për shkak të të cilit personit iu ndalua hyrja. Gjithashtu Komisioni i rekomandoi diskriminuesit që viktimës t’ia kompensojë dëmin brenda 30 ditësh.

Pas marrjes së Mendimit dhe gjatë konsultimit me Komitetin e Helsinkit, viktima si palë e dëmtuar dhe diskriminuesi si shkaktar i dëmit, ranë dakord për të zgjidhur mosmarrëveshjen jashtë gjykatës. Për atë qëllim, ata lidhën marrëveshje kompensimi në të cilën diskriminuesi pranoi fajësinë për ngjarjen dhe të dy palët ranë dakord për shumën e kompensimit, si dhe kushtet e pagesës. Kjo është marrëveshja e parë e nënshkruar jashtë gjykatës për kompensim për shkak të diskriminimit në bazë të identitetit gjinor, që është një hap i madh para në luftën kundër diskriminimit.

6. Diskriminim bazuar në orientimin seksual dhe gjuhë degraduese ndaj personave LGBTI

Komiteti i Helsinkit, Qendra për mbështetje LGBTI dhe LGBT Junajted Tetovë paraqitën ankesë për diskriminim pranë Komisionit për Mbrojtje nga Diskriminimi, për shkak të një kolumne shqetësuese në portalet shqiptare me titull “Homoseksualët - pederat e sotëm”, shkruar nga një profesor i një shkolle të mesme profesionale në Tetovë. Në kolumnë autori përdor një fjalor jashtëzakonisht diskriminues, shqetësues dhe degradues ndaj personave LGBTI.

Pas parashtresës, autori i kolumnës kërkoi falje publike, duke i kërkuar falje të gjithë komunitetit LGBTI dhe shkroi se teksti i tij nuk kishte për qëllim të ofendojë ose diskriminojë askënd, sepse orientimi seksual është e drejtë personale e secilit.

PROCEDURA GJYQËSORE:

1. Profilizimi racor në pikat kufitare

Gjatë muajit gusht 2014, Komiteti i Helsinkit bëri një testim të situatës, që kishte për qëllim të dëshmojë profilizimin racor dhe etnik si dhe kufizimin e pabazuar të së drejtës për të lëvizur ndaj romëve në pikat kufitare në Republikën e Maqedonisë. Në testim morrën pjesë gjashtë persona, prej të cilëve katër ishin romë, një maqedonas dhe një shqiptar dhe u përsërit dy herë. Testimi u krye në një autobus, i cili po udhëtonte për në qytetin e Bujanocit, në Republikën e Serbisë, nëpërmjet vendkalimit ndërkuftar “Tabanovcë”. Qëllimi i udhëtimit ishte vizitë miqve. Në të dyja rastet, oficerët e policisë nga autobusi i zbritën vetëm romët dhe i pyetën për ku po udhëtonin, sa para kanë me vete, cili ishte qëllimi i udhëtimit të tyre. Me këtë u vërtetua profilizimi racor ndaj romëve në pikat kufitare. Rezultatet e testimit ishin një nga dëshmitë në procedurën e inicuar gjyqësore për të vërtetuar diskriminimin sistematik nga ana e shtetit ndaj bashkësisë etnike rome, por gjithashtu edhe 31 raste të diskriminimit ndaj romëve të cilët morën pjesë në testim dhe të cilët ishin të diskriminuar në pikën kufitare Tabanovcë.

Gjykata Themelore Shkup 2 nuk arriti të vërtetojë diskriminim në këtë rast, me shpjegimin se nuk ka diskriminim, pasi që paditësve nuk u është kufizuar e drejta për të lëvizur. Megjithatë, Gjykata e pranoi testimin e situatës si mjet dëshmie për të provuar diskriminimin, që nga ana tjetër lejon mundësinë që në të ardhmen kjo metodë të përdoret si mjet dëshmie në procedura të ardhshme gjyqësore lidhur me vërtetimin e diskriminimit.

Duke qenë se Gjykata nuk arriti të konstatojë diskriminim sistematik ndaj komunitetit etnik Rom, e as diskriminim ndaj paditësve individualë, për këtë rast do të përgatitet një kërkesë në Gjykatën Evropiane të të Drejtave të Njeriut, për shkelje të së drejtës për trajtim të barabartë për shkak të profilizimit racor të Romëve.

2. Segregacioni i fëmijëve romë në procesin arsimor (actio popularis)

Komiteti i Helsinkit, së bashku me KHAM Delçevë, Institutin për të Drejtat e Njeriut, Fondacionin Shoqëria e Hapur Maqedoni dhe Qendrën Evropiane për të Drejtat e Romëve, inicuan proces gjyqësor për vërtetimin e diskriminimit të vazhdueshëm ndaj fëmijëve Romë, për shkak të sistemimit të tyre të tepruar në arsimin special (shkolla speciale dhe klasa speciale brenda shkollave të rregullta). Pala e akuzuar në këtë rast ishte Qeveria, si përgjegjëse për problemin, si dhe për faktin se nuk ka ndërmarrë kurrfarë veprime dhe masa konkrete për eliminimin e pasojave të kësaj praktike diskriminuese.

Interesi juridik i paditësve për inicimin e procedurës gjyqësore actio popularis për këtë problem, lind nga veprimi i deriatëhershëm i tyre në këtë fushë. Me faktin që prindërit dhe fëmijët iu drejtuan këtyre organizatave dhe folën për problemet që ua shkaktonte kjo praktikë, si dhe për faktin që bashkëpunonin gjatë hetimeve të bëra, Gjykata duhet të kishte konsideruar se viktimat kanë rënë dakord të mbrojnë të drejtat e tyre. Për më tepër, Gjykata duhet të vlerësojë se në rastin konkret bëhet fjalë për një diskriminim sistematik që përfshin një numër të pafund personash. Për këto arsye nuk mund të kërkohej e as të merret pëlqimi prej të gjithë grupit. Nga ana tjetër, është e paqëndrueshme që Gjykata të konsiderojë se pëlqimi i një fëmije, dmth. i një prindi ose kujdestari mund të përfaqësojë interesat e të gjithë grupit.

Megjithatë, Gjykata vendosi të hedhë poshtë padinë, duke u thirrur në mungesën e pëlqimit të viktimës së diskriminimit, në përputhje me nenin 41 paragrafi 4 të Ligjit për Parandalim dhe Mbrojtje nga Diskriminimi. Edhe pse Gjykata në arsyetimin e vendimit pranon që paditësit kanë një interes të arsyeshëm për zhvillimin e procedurës, përsëri konsideron se një proces i tillë gjyqësor nuk mund të lejohet pasi që nuk ka pasur pëlqim me shkrim nga viktimat e diskriminimit, edhe pse në Ligjin për parandalimin dhe mbrojtjen nga diskriminimi nuk specifikohet qartë forma në të cilën duhet të jepet pëlqimi. Ky vendim u konfirmua edhe nga Gjykata e Apelit Shkup.

Ky rast tregon se ekziston nevojë urgjente për ndryshimin e Ligjit për parandalimin dhe mbrojtjen nga diskriminimi, në pjesën që ka të bëjë me mundësinë që shoqatat e qytetarëve të inicojnë procedura gjyqësore actio popularis. Ndryshimet duhet të jenë në drejtim që të mos ketë kufizim për pëlqim të detyrueshëm nga viktimat e diskriminimit dhe të mos jetë e detyrueshme padia e përbashkët për verifikimin e diskriminimit. Në këtë mënyrë, shoqatave të qytetarëve do t'u lihet mundësia të inicojnë procedura gjyqësore në emër të grupeve të tëra të qytetarëve të diskriminuar dhe kështu të mbrojnë interesin e tyre, por edhe interesin publik dhe të inicojnë ndryshime shoqërore.

VI. TË DREJTAT EKONOMIKE DHE SOCIALE

1. Hyrje:

Gjatë vitit 2016, në Komitetin e Helsinkit u regjistruan një numër i madh parash-tresash për shkelje të të drejtave ekonomike dhe sociale, që është pasojë e shkallës së lartë të papunësisë në vend, varfërimit të popullatës, shkelje të të drejtave të punës, sociale dhe shëndetësore. Këtë vit, vëmendje e veçantë iu kushtua të drejtave të personave me aftësi të kufizuara, të cilët Komitetit të Helsinkit i dorëzuan një numër të madh parash-tresash për shkak të pamundësisë për të ushtruar të drejtat e përcaktuara me ligj për këtë kategori personash.

Sa i përket të drejtave të personave me aftësi të kufizuara, nuk është shënuar kur-rfarë përparimi dhe këta persona përballen me vështirësi në jetën e tyre të përditshme - që nga mungesa e qasjes në të gjitha institucionet në fushën sociale, shëndetësore dhe arsimore e deri te pamundësia për të ushtruar të drejtat sociale, të garantuara me Kushtetutë dhe me ligj.

Një problem veçanërisht i rëndësishëm e që imponohet gjithnjë e më shumë çdo vit, për shkak të rritjes së varfërisë në vend, është problemi i të pastrehëve, për të cilin shteti ende nuk ka zgjidhje.

Një problem tjetër që është regjistruar gjatë vitit 2016, dhe i cili është prezent për shumë vite, është problemi me shkeljen e vazhdueshme të të drejtave të punëtorëve dhe mobingu i punëdhënësve mbi punëtorët e tekstilit.

RASTE TË VEÇANTA:

2. Shteti nuk ka zgjidhje afatgjatë për romët e zhvendosur nga vendbanimi nën Kala

Në gusht 2016, 29 familje rome ose 121 persona, përfshirë 64 fëmijë, 10 foshnje dhe tri gra shtatzëna, i zhvendosën nga banesat e tyre të improvizuara nën Kalanë e Shkupit. Këta njerëz u lanë të jetonin nën qiell të hapur dhe pa kushte minimale të jetesës për më shumë se 3 muaj, kurse institucionet shtetërore nuk ndërmorën

asnjë hap për të zgjidhur problemin e tyre të strehimit. Si rezultat i kësaj si dhe i mungesës së higjienës personale, shumë njerëz zhvilluan infeksione të lëkurës si dhe një sërë problemesh shëndetësore. Për më tepër, disa prej tyre nuk kishin dokumentacion personal, kështu që nuk mund të realizonin të drejtat e mbrojtjes shëndetësore dhe sociale.

Personat, të mbështetur nga më shumë organizata që punojnë në mbrojtjen e të drejtave të Romëve, organizuan një protestë para Qytetit të Shkupit, duke kërkuar pranim nga autoritetet e qytetit dhe zgjidhje të problemit të tyre. Përmes kontakteve të bëra dhe takimeve të zhvilluara me organet kompetente, mund të konkludojmë se institucionet ia kanë hedhur njëri-tjetrit përgjegjësinë për zgjidhjen e problemit dhe deri më sot nuk kanë gjetur kurrfarë zgjidhje.

Qendra Ndër-Komunale për Punë Sociale Shkup, si zgjidhje të vetme propozoi që personat të strehohen në qendrën e pritjes në “Chichino Selo”, e cila përkundër faktit që nuk ka kapacitet për të akomoduar të 29 familjet, nuk ka as kushte adekuate të jetesës. Pas më shumë se 3 muajve dhe një varg takimesh dhe negociatash me institucionet shtetërore, një pjesë e personave të zhvendosur u vendosën përkohësisht në Institutin për kujdesin, edukimin dhe arsimimin e fëmijëve dhe të rinjve “Ranka Milanoviç” dhe në Entin publik për kujdesin e fëmijëve me probleme edukative - sociale “25 maji”, kurse një pjesë e tyre mbetën nën qiellin e hapur, në vendin ku kanë qenë të vendosura banesat e improvizuara.

Shteti ende nuk arrin të gjejë një zgjidhje të përhershme për problemin e strehimit të këtyre njerëzve, duke dështuar kështu të përmbushë detyrimin e vet kushtetues për t’u kujdesur për mbrojtjen sociale dhe sigurinë shoqërore të qytetarëve në përputhje me parimin e drejtësisë sociale dhe detyrimin për të siguruar mbrojtje për ata qytetarë që nuk kanë mundësi për ekzistencë materiale dhe shoqërore.

3. Problemet reale me të cilat përballen personat me aftësi të kufizuara fizike

Gjatë vitit 2016, Komiteti i Helsinkit veproi mbi parashtrirat ose informatat e marra nga prindërit e personave me aftësi të kufizuara fizike, të cilat kryesisht i referoheshin fushës së arsimit ose mbrojtjes sociale.

Problemet më të mëdha me të cilat përballen fëmijët me aftësi të kufizuara:

- Pranimi i fëmijëve në kopshte është i kufizuar dhe në shumicën e kopshteve fëmijët refuzohen, me arsyetimin se kopshti nuk ka kuadër profesional që do të dinte të merrej me këta fëmijë dhe nevojat e tyre.

- Pranimi i fëmijëve në shkolla kushtëzohet me dorëzimin e dokumentacionit për aftësinë e fëmijës të mësojë në shkollë të rregullt, e në disa raste, dokumentacioni kërkohet disa herë.

-Për pranim në shkollë, prindërit shpesh kanë qenë të detyruar të drejtohen në institucionet më të larta, ose të kërkojnë ndihmë nga miqtë e tyre.

-Mundësitë e qasjes fizike deri tek shkollat, janë në nivelin më të ulët dhe sipas pretendimeve të prindërve, qasje të këtilla ka vetëm në 2 shkolla fillore në Shkup, kurse ashensor nuk ka në asnjë shkollë.

-Shkollat speciale nuk kanë qasje adekuate e as persona profesional për punë individuale me fëmijët me aftësi të kufizuara fizike.

-Nëpër shkolla mungon senzibiliteti i të punësuarve ndaj problemeve të fëmijëve me aftësi të kufizuara fizike. Pas pranimit në shkollë, fëmijët e tyre janë shpërndarë në klasa në katin e sipërm të ndërtesës së shkollës, gjë që e bën të vështirë të lëvizin e tyre edhe më të vështirë, dhe më vonë në klasat e larta, me mësimin kabinetik, lëvizja e fëmijës bëhet pothuajse e pamundur.

- Për shkak të nevojës që fëmija të ngjitet në katin e sipërm për të shkuar në mësim, e më vonë, me mësimin kabinetik, të lëvizë prej klase në klasë, ose për të shkuar në tualet, prindërit janë të detyruar që vazhdimisht të vijnë në shkollë dhe vetë t'u ndihmojnë fëmijëve për t'u zhvendosur, për arsye se mungon staf mbështetës.

- Rregullat në fushën e shëndetësisë dhe mbrojtjes sociale, më së shpeshti rregulloret, janë të përcaktuara në atë mënyrë që realizimi i disa të drejtave, pengon realizimin e të drejtave të tjera, dmth ato përjashtohen nga njëra-tjetra.

- Aparatet ndihmëse medicinale kryesisht jepen falas, por pjesët shtesë, pjesët rezervë dhe servisimi i tyre paguhen. Përveç që paguhen, ndodh shpesh që nuk mund t'i gjejnë pjesët e nevojshme.

4. Maqedonia nuk shënon progres në realizimin e të drejtave sociale, ekonomike dhe kulturore

Komiteti i KB-ve për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore, pasi shqyrtoi raportin periodik të Maqedonisë, publikoi konstatimet përmbyllëse. Në këtë dokument, Komiteti i jep tridhjetë rekomandime konkrete Maqedonisë se si të përbushë detyrimet që dalin nga Pakti ndërkombëtar i ratifikuar për të drejtat ekonomike, sociale dhe kulturore. Përmenden më shumë fusha dhe probleme për të cilat duhet të ndërmerren masa: regjistrimi i popullatës, Avokati i Popullit, korrupsioni dhe mosdiskriminimi. I kushtohet vëmendje problemeve të varfërisë, pagës minimale, strehimit, ushqimit, të drejtës për grevë, papunësisë dhe të drejtës për arsim.

Komiteti i rekomandoi Republikës së Maqedonisë që në Ligjin për parandalimin dhe mbrojtjen nga diskriminimi të përfshijë orientimin seksual dhe identitetin gjinor si baza për mbrojtje nga diskriminimi. Për herë të parë, Komiteti ia imponon shtetit detyrimin që çifteve të gjinisë së njëjtë, t'u lejojë qasje në privilegjet e rezervuara për çiftet e martuara. Me qëllim të eliminimit të stereotipeve dhe stigmatizimit ndaj personave LGBTI, shteti ka për detyrë të kryejë një hetim efikas për të zgjidhur rastet e dhunës ndaj personave LGBTI. Komiteti rekomandon që shteti të përmirësojë kushtet e jetesës në qendrat e tranzitit për refugjatët, të ndalojë zbatimin e paligjshëm retroaktiv të Ligjit për Mbrojtjen Sociale dhe heqjen e paligjshme të së drejtës për ndihmë financiare sociale, të sigurojë mbrojtje efikase dhe adekuate për të gjitha viktimat e dhunës në familje, të kryejë një hetim efikas dhe në kohë për të gjitha rastet e raportuara të dhunës në familje dhe t'i ndërmerr të gjitha masat e nevojshme për të parandaluar segregacionin e fëmijëve romë në sistemin arsimor.

5. Institucionet kompetente dështuan në parandalimin dhe menaxhimin e pasojave të përmbytjes

Më 06.08.2016, qyteti i Shkupit u prek nga një stuhi e madhe dhe shira të rrëmbyeshëm, në disa pjesë të qytetit pati përmbytje të mëdha që prekën disa zona të qytetit dhe i shkatërruan plotësisht ato. Në përmbytjet, jetën e humbën 22 persona, gjashtë persona janë të zhdukur dhe rreth 100 persona të lënduar. Ky bilanc i zi i jetëve të humbura, mund dhe duhej të shmangej, poqese institucionet kompetente dhe organet e menaxhimit të krizave do të kishin përmbytur plotësisht detyrimet e tyre ligjore për parandalimin dhe veprimin në rast përmbytjesh.

Drejtoria për Mbrojtje dhe Shpëtim (DMSH), Qendra e Menaxhimit të Krizave (QMK), Parlamenti i Republikës së Maqedonisë, Qeveria e Republikës së Maqedonisë dhe organet e administratës shtetërore janë institucionet që kanë kompetencë më të madhe në fushën e parandalimit të fatkeqësive elementare dhe përmbytjeve.

Në ditët pas përmbytjes, pati një koordinim joadekuat të komponentëve të caktuar në sistemin e menaxhimit të krizave, veprim joadekuat të institucioneve dhe organeve të caktuara dhe dështim total të sistemit. Komiteti i Helsinkit beson se është bërë lëshim i madh në marrjen e masave parandaluese për mbrojtje, si dhe në mënyrën e menaxhimit me fatkeqësinë natyrore që goditi zonën e qytetit të Shkupit. Organet kompetente shtetërore nuk i ndërmorrën masat parandaluese të përcaktuara me ligj. Mënyra e vlerësimit të rrezikut nga fatkeqësitë natyrore është e vjetëruar dhe nuk korrespondon me situatën reale faktike. Qytetarëve nuk u është dërguar asnjë paralajmërim për t'u përgatitur për stuhinë e fortë, gypat dhe një pjesë e madhe e rrjetit të kanalizimeve nuk kanë qenë të pastruara e as nuk janë ndërtuar objekte mbrojtëse.

Organet e administratës shtetërore vazhdimisht tregojnë se jo vetëm që nuk kanë kapacitete për të menaxhuar këtë krizë, por veprojnë edhe në kundërshtim me rregullat pozitive ligjore. Veprimi i këtillë i organeve të administratës shtetërore pas përmbytjes dhe mosmarrja e masave parandaluese për mbrojtje, janë fajtorët e drejtpërdrejtë për bilancin e zi të viktimave në këtë përmbytje katastrofike.

6. Shkelja e vazhdueshme e të drejtave të punës dhe mobingu ndaj punëtoreve të tekstilit

Përmes rasteve të dokumentuara gjatë dhënies së ndihmës juridike falas, Komiteti i Helsinkut në vitin 2016 regjistroi një seri shkeljesh të të drejtave të punëtorëve dhe mobing ndaj punëtoreve të tekstilit, të kryera nga punëdhënësit e tyre, kryesisht në fabrikat e tekstilit dhe lëkurës në pjesën lindore të vendit. Shkelja e të drejtave më së shpeshti ka të bëjë me pagesën e vonuar të pagave për punonjësit nga punëdhënësi, mospagesën e pagave dhe kontributeve ligjore për sigurim shëndetësor dhe pensional, mosrespektimin e dispozitave ligjore për orarin e punës, orët shtesë, pagat e orëve shtesë, ngacmimet psikike në vendin e punës, sigurimin e pushimit ditor dhe vjetor, sigurimin e kushteve të sigurisë në punë, si dhe pagesën e shtesës ligjore në pagë, për punën në ditë jopune dhe festa shtetërore.

Për këtë qëllim, Komiteti i Helsinkit iu drejtua Sektorit për mbikëqyrje në sferën e punës pranë Inspektoratit shtetëror të punës dhe kërkoi inspektim të jashtëzakonshëm të 22 konfeksioneve për tekstil dhe lëkurë në Shtip, Kriva Pallankë, Koçanë dhe Dellçevë, për inspektim të situatës lidhur me respektimin e të drejtave të punës të punëtoreve të tekstilit nga punëdhënësit e tyre.

Inspektorati shtetëror i punës verifikoi parregullësi dhe mangësi në zbatimin e dispozitave ligjore dhe shkelje të të drejtave të punëtorëve, vetëm në dy raste, nga 22 rastet e paraqitura, dhe u dha afat punëdhënësve që t'i mënjanonjë parregullësitë e verifikuara. Njëra nga konfeksionet veproi sipas rekomandimeve të Inspektoratit, kurse në rastin tjetër, Inspektorati kërkoi nisjen e procedurës për kundërvajtje për shkak të mosveprimit pas urdhërit të lëshuar, që rezultoi me sanksionim në të holla të konfeksionit.

Gjatë kësaj periudhe, Komiteti i Helsinkit mbajti disa trajnime me punëtorët e tekstilit me qëllim që të njihen me të drejtat e punës dhe me shfrytëzimin e mekanizmave për mbrojtjen e të drejtave.

Problem të madh në mbrojtjen e të drejtave të punës të punëtoreve të tekstilit, veçanërisht atyre që lidhen me pagesën e rregullt të pagave, kontributeve të pagave dhe shtesave të pagave, paraqet qasja në drejtësi. Gjegjësisht, mekanizmat

mbrojtës për të drejtat e punëtorëve, të cilat janë falas, pra u janë në dispozicion punëtorëve të tekstilit, janë procedura administrative, të cilat në rast të konstatimit të shkeljes së të drejtave të punëtorëve, mund të rezultojnë me sanksionimin e punëdhënësit. Përmes këtyre procedurave, punëtorëve të tekstilit nuk u jepen të hollat që ato i kërkojnë, përkatësisht pagat që nuk u janë paguar, kontributet për paga dhe shtesat në pagë. Kompenzimi i këtyre mjeteve mund të kërkohet vetëm në procedurat gjyqësore, të cilat kanë kosto të madhe në të holla, si për taksë gjyqësore, shpenzime për avokatë, për ekspertizë, të cilat punëtorët e tekstilit nuk mund t'i përballojnë, për shkak të statusit të tyre të ulët social-ekonomik.

VII. GJUHA E URREJTJES

Gjatë krizës më të thellë politike dhe shoqërore në Republikën e Maqedonisë, gjatë vitit 2016, u vërejt përhapje dhe promovim i gjuhës së urrejtjes në përmasa të papara. Zhvillimet dinamike në skenën e brendshme politike, kriza e refugjatëve, mbajtja e zgjedhjeve të parakohshme parlamentare, si dhe zhvillime të ndryshme në suaza ndërkombëtare, kontribuan në intensifikimin e gjuhës së urrejtjes. Përkatësia etnike, përcaktimi politik dhe orientimi seksual, si edhe vitin e kaluar, vazhdojnë të jenë motivet kryesore për gjuhën e urrejtjes në Republikën e Maqedonisë. Shqetëson rritja e gjuhës së urrejtjes tek të rinjtë, e helmuar me porosi nacionaliste, thirrje për mostolerancë ndaj bashkësive etnike në vend dhe e mbushur me propagandë politike. Qëndrimi injorues dhe qasja selektive e institucioneve kompetente, gjegjësisht policisë, prokurorëve publikë dhe gjykatave, kontribuan në rritjen serioze të gjuhës së urrejtjes, përmes mosndëshkimit të autorëve dhe paaftësisë për të marrë përgjegjësi shoqërore për përhapjen e këtij fenomeni negativ.

Duke monitoruar gjuhën e urrejtjes në Internet dhe në opinion, Komiteti i Helsinkit, në platformën www.govornaomraza.mk regjistroi 136 raste të raportuara të gjuhës së urrejtjes, nga të cilat 133 u verifikuan. Shumica e parashtresave i referohen gjuhës së urrejtjes që u shfaq në hapësirën e internetit dhe rrjeteve sociale. Një numër më i vogël, por gjithsesi i konsiderueshëm i rasteve të gjuhës së urrejtjes u regjistruan në hapësirën publike, pra në formën e mbishkrimeve të shkruara (kryesisht mbi baza etnike) dhe në tubimet publike. Nga ngjarjet më të rëndësishme që drejtpërsëdrejti provokuan dhe prodhuan gjuhë urrejtjeje, veçojmë si vijon:

Gjatë shkurtit, në Fushë Topanë në Shkup u vu monumenti i shqiptarëve dykrerësh. Përderisa komnatat kompetente reagonin me habi dhe paqartësi se kush e ngriti monumentin, në rrjetet sociale vërshoi gjuha e urrejtjes mbi baza etnike dhe kombëtare. Tensionet etnike dhe mosdurimi u shtuan edhe më shumë, me vendosjen e menjëhershme të një kryqi prej 51 metrash në komunën e Butelit. Si pasojë e gjuhës së përhapur të urrejtjes, të pashmangshme ishin edhe veprimet e urrejtjes, kur gjatë fillimit të aktiviteteve ndërtimore për vendosjen e kryqit, nga pjestarë të bashkësisë etnike shqiptare u sulmua Todor Petrov (kryetar i Kongresit botëror maqedonas, inicues i vendosjes së kryqit). Megjithëse ngjarja tërhoqi vëmendjen e zyrtarëve të lartë politikë, mungoi dënimi publik i një akti të tillë dhe i gjuhës së

urrejtjes, që ndoqi gjithë ngjarjen.

Gjatë qershorit, u vërejt prani e konsiderueshme e gjuhës së urrejtjes në rrjetet sociale, si rezultat i sulmit ndaj një klubi homoseksualësh në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Në vend që të dënojnë ngjarjen dhe të mbështesin viktimat, qytetarët maqedonas në rrjetet sociale ndanë komente në mbështetje të një ngjarjeje të tillë, thirrje për dhunë ndaj të gjithë komunitetit LGBTI dhe promovim të qëndrimeve homofobike, duke bërë thirrje për sulme të tilla në të ardhmen. Komiteti i Helsinkit përkujton se si pasojë e këtij fjalori homofobik, që është shpesh i pranishëm në Republikën e Maqedonisë dhe mungesës së përndjekjes së tij, Qendra për Mbështetje LGBTI, në të kaluarën ishte viktimë e 6 sulmeve, të cilat deri më sot nuk kanë asnjë zgjidhje juridike.

Pasi që u shtyen dy herë dhe pas një krize të ashpërsuar politike, më në fund, zgjedhjet e parakohshme parlamentare u caktuan për 11 Dhjetor 2016. Periudha parazgjedhore, ashtu si në vitet e mëparshme, u tregua si periudhë më e frytshme për gjuhën e urrejtjes. Si pasojë, retorika nacionaliste në fushatën zgjedhore të partive të caktuara politike, si dhe imponimi i detyruar i marrëdhënieve ndëretnike, si një nga çështjet kryesore, e vendosën përkatësinë etnike si bazën më të përhapur për gjuhën e urrejtjes. Gjatë kësaj, titujt senzacionalë mediatikë në lidhje me “federalizimin e Maqedonisë” dhe “implementimin e dygjuhësisë” kontribuan në mënyrë të konsiderueshme në procesin e nxitjes së intolerancës ndëretnike. Retorika e ashpërsuar deri në përmasa ekstreme midis të gjitha partive politike, si dhe etiketimi i çdo qytetari që nuk e mbështet partinë politike në pushtet, si tradhtar dhe mbështetës të partive opozitare, e bëri përcaktimin politik, bazën e dytë më të përhapur për gjuhën e urrejtjes që përhapej vazhdimisht në rrjetet sociale dhe internet.

Pasojat negative nga përhapja e gjuhës së urrejtjes në bazë të përkatësisë etnike, ishin të pashmangshme. Kështu, më 22 nëntor, Ditën e Alfabetit Shqip, në orët e vona të mbrëmjes, Muzeu i Alfabetit Shqip në Manastir u demolua për herë të katërt. Përveç kësaj, në muret e jashtme të Muzeut ishin shkruar thirrje për “vdekjen e shiptarve” dhe ishin vizatuar kryqe të thyer. Organizata të shumta bënë thirrje për një reagim të menjëhershëm të institucioneve kompetente, duke theksuar se mosndjekja penale dhe mosndëshkimi i veprave të tilla, paraqet miratimin dhe inkurajimin e tyre. Pavarësisht thirrjeve dhe gjykimeve të shumta, autorët e këtyre veprave të urrejtjes akoma nuk janë zbuluar.

Rezultatet e paqarta të zgjedhjeve dhe tensioni gjithnjë e më i madh politik, kontribuan në shtimin e gjuhës së urrejtjes ndaj përcaktimit politik. Menjëherë pas shpalljes së rezultateve të zgjedhjeve dhe njoftimit të Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve për shqyrtimin e ankesave të paraqitura nga partitë politike, qytetarët organizuan një protestë përpara selisë së Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve, që të shprehin revoltën e tyre. Në protestat morën pjesë simpatizues, anëtarë dhe funksionarë të partisë së deriatëhershme në pushtet, VMRO-DPMNE. Një nga tiparet shqetësuese të protestës ishte promovimi dhe përhapja e gjuhës së urrejtjes bazuar në përkatësinë politike. Gjuha e urrejtjes, përveç në brohoritjet e turmës “shiptarët e mallkuar”, u vërejt edhe në fjalimet e bartësve të zgjedhur të funksionit publik, dmth. deputetëve të mëparshëm, drejtorëve dhe vetë ish-kryeministrit, i cili pati fjalim në tubim. Në fjalimet e tyre, ata në nënyrë të drejtpërdrejtë dhe të tërthortë kërcënuan liderin e partisë politike të opozitës, si dhe, në një rast, kërcënuan një ambasador të huaj. Synimi i folësve ishte i qartë, e kjo është të provokojnë urrejtje, përçarje dhe intolerancë bazuar në përkatësinë politike, e në disa raste edhe në përkatësinë etnike. Konteksti, pra kriza e thellë shoqërore - politike dhe ndarja e njerëzve, ishin një rrethanë tjetër ngarkuese, e cila çon në mënyrë të pashmangshme në kryerjen e veprave të urrejtjes. E gjithë kjo çon në përmbushjen e plotë të thelbit të veprës penale Nxitje e urrejtjes, përçarjes ose intolerancës për shkaqe nacionale, racore, fetare ose bazë tjetër diskriminuese, sipas nenit 319 të Kodit Penal të Republikës së Maqedonisë, për të cilën veprë është paraparë edhe dënimi me burg. Mjerisht, përsëri munguan reagimet e policisë ose të prokurorisë publike, të cilat janë kompetente për fillimin e procedurave penale gjatë përhapjes dhe promovimit të gjuhës së urrejtjes në hapësirë publike.

Fundi i vitit u pasua nga një shembull pozitiv në luftën kundër gjuhës së urrejtjes. Në fund të dhjetorit 2016, Agjencia e Shërbimeve të Mediave Audio dhe Audiovizuale kishte bërë një mbikëqyrje të jashtëzakonshme mbi punën e TV Sitelit, ku ka mbikëqyrur raportimin e televizionit në fushatën parazgjedhore. Mbikëqyrja është bërë nga data 2 deri më 5 dhjetor 2016 dhe i referohet emitimit të Ditarit që transmetohet në ora 19:00 dhe 23:00. Në [raportin](#) e përgatitur, Agjencia informon se lëndë konkrete e mbikëqyrjes së bërë është shkelja e nenit 48 të Ligjit për Shërbimet e Mediave Audio dhe Audiovizive, i cili ndalon shprehimisht programe që nxisin ose përhapin diskriminim, intolerancë ose urrejtje bazuar në racë, gjini, religjion ose kombësi.

Ajo që është më e rëndësishme nga mbikëqyrja e kryer është se Agjencia konstatoi se televizioni Sitel ka përhapur dhe promovuar gjuhën e urrejtjes duke transmetuar një seri edicionesh radhazi të programit të lajmeve ditore “Dnevnik”, me titull “Dygyhësia ka një çmim”. Në fakt, përmbajtja dhe gjuha e përdorur në programin e emituar, sipas Agjencisë, “ka për qëllim imponimin e mendimit, manipulimin me informatat dhe frikësimin me humbje të vendeve të punës, humbjen e shtetit, tensione dhe luftë, përdorimin e taktikave të emërimit të profesioneve, qyteteve / komunave dhe bashkësive etnike të cilat duhet të ndjehen të kërcënuara “. Agjencia konkludon se edicionet përmbajnë gjuhë eksplicite të urrejtjes, nxisin dhe përhapin intolerancë, diskriminim dhe urrejtje në bazë të kombësisë / etnisë. Raportin dhe konstatimet, Agjencia ia dorëzoi Komisionit për mbrojtjen nga diskriminimi dhe Zyrës themelore të Prokurorit publik, me qëllim që të merren masat e duhura dhe të ndëshkohet përhapja dhe promovimi i gjuhës së urrejtjes. Komiteti i Helsinkit e mirëpriti këtë shembull pozitiv të njohjes dhe dënimit të gjuhës së urrejtjes, veçanërisht duke pasur parasysh rrezikun prej saj, kur ajo përhapet dhe promovohet në mjetet e informimit publik, mediat.

VIII. VEPRA NGA URREJTJA

Në periudhën nga 1 janari deri më 31 dhjetor 2016, Komiteti i Helsinkit regjistroi gjithsej 70 vepra urrejtjeje. Shumica e incidenteve janë regjistruar menjëherë pasi ato janë raportuar nga mediat ose botuar në buletinet ditore në web faqen e internetit të Ministrisë së brendshme, ndërsa për 3 (tre) incidente kanë raportuar vëzhguesit e Komitetit të Helsinkit ose persona të tjerë. Nga të gjitha incidentet, 35 u verifikuan përmes shkresave drejtuar Ministrisë së brendshme, buletineve ditore të Ministrisë së brendshme, raporteve të mediave dhe takimeve me viktimat e veprimeve të tilla.

Incidentet tjera të mbetura (35) nuk u verifikuan, por u dokumentuan për shkak të ekzistimit të mosobjektivitetit, duke përfshirë: perceptimin e viktimës / dëshmitarit; komentet në vendin e ngjarjes; dallimin midis viktimës dhe kryerësit mbi baza etnike; modeli / frekuenca e incidenteve të mëparshme; natyra e dhunës; mungesa e motiveve të tjera; vendndodhja dhe koha. Në fakt, incidentet e paverifikuara u përfshinë për shkak të informacionit të marrë në lidhje me vendndodhjen e incidentit (për shembull, lagje dhe shkolla etnikisht të përziera, linja autobusi që shfrytëzohen nga pjestarë të bashkësive të ndryshme etnike, dmth. tranzitojnë nëpër vendet me përbërje të përzier etnike, vendet ku krimet e urrejtjes kanë ndodhur në të kaluarën, etj.), llojit të incidentit (për shembull, një grup i madh i të miturve sulmon një ose më shumë viktimë pa provokim, përleshje në grup, sulm në autobus ose stacion autobusi, etj.), koha e incidentit (pas përleshjes, si një formë hakmarrjeje, pas orëve të mësimi, gjatë ose pas ngjarjeve sportive, etj.) dhe pronës së dëmtuar gjatë incidentit (për shembull, objekte fetare, selitë e partive, etj.). Incidentet e verifikuara dhe të paverifikuara janë shënuar me të gjelbër, përkatësisht me të kuqe në portalin e Komitetit të Helsinkit - www.zlostorstvaodomraza.mk.

Krahasuar me vitin 2015, ndryshimi më i madh në vitin 2016 është në motivin e incidenteve të urrejtjes. Përderisa në vitin 2015 motivi për shumicën e incidenteve ishte statusi i refugjatit ose migrantit i personave që kalonin tranzit nëpër Republikën e Maqedonisë, në vitin 2016 motivi për shumicën e incidenteve është përkatësia etnike, përkatësisht përkatësia politike ose bindjet e viktimave dhe autorëve të krimit.

Rrjedhimisht, përderisa vitin e kaluar, shumica e incidenteve kishin të bëjnë me gra-

bitjen e refugjatëve që tranzitonin nëpër territorin e shtetit, këtë vit më të shumta janë incidentet që përfshijnë dhunën midis personave të përkatësisë etnike maqedonase dhe shqiptare, si dhe dëmtimet e selive të partive, bilbordeve të partive politike, veçanërisht në periudhën parazgjedhore.

Ndryshe nga viti 2015, kur u vu re rënie e numrit të incidenteve të kryera për shkak të përkatësisë etnike maqedonase ose shqiptare të viktimës apo të autorit, në vitin 2016, ndjeshëm u rrit numri i incidenteve të tilla. Në vitin 2016, përkatësia etnike e viktimës ose autorit, ishte motivi për pothuajse gjysmën e incidenteve të regjistruara. Për krahasim, në vitin 2013 ky lloj i incidenteve përfaqësonte 84% të të gjitha incidenteve të regjistruara (98 nga 116), në vitin 2014 kjo shifër ishte 61% (53 nga 87), në 2015 kjo shifër ishte 34% (15 nga 44), ndërsa në vitin 2016, numri u rrit përsëri në 48.5% (34 nga 70).

Numri më i madh i incidenteve ndodhi në nëntor (18 incidente; 26% të numrit të përgjithshëm të incidenteve të regjistruara), do të thotë në periudhën parazgjedhore, kur kishte një prani të konsiderueshme të gjuhës së urrejtjes në media. Shumica e veprave të urrejtjes janë kryer nga të rinjtë. Veprat penale më të shpeshta janë Dhuna (28), Dëmtimi i pasurisë së personave të tjerë (27), Lëndimi trupor (26), Nxitja e urrejtjes, përçarjes ose jotolerancës në baza kombëtare, racore, fetare dhe arsye të tjera diskriminuese (23), Pjesëmarrja në përleshje (10).

Numri më i madh i incidenteve ka ndodhur në Shkup dhe rrethinë (42), shumica e të cilave në komunën e Çairit (8) dhe në komunën Gjorçe Petrov. Nga qytetet tjera në Maqedoni, numri më i madh i incidenteve ka ndodhur në Kumanovë (8), si dhe në Manastir, Demir Kapi dhe Tetovë - komuna e Tearcës (nga 4 në secilin prej këtyre qyteteve).

U evidentuan më së paku 89 viktima dhe 211 autorë të veprave të urrejtjes. Shumica e viktimave janë të rinj dhe refugjatë ose migrantë. Nga numri i përgjithshëm i viktimave, të paktën 31 person janë refugjatë ose migrantë (shumica e të cilëve janë me origjinë marokene), dhe të paktën 9 janë të mitur. Nga numri i përgjithshëm i autorëve, për 12 u konfirmua se ishin të mitur, për 13 të tjerë supozohet se poashtu ishin të mitur, duke pasur parasysh se bëhet fjalë për nxënës të shkollave të mesme.

Sipas përgjigjeve me shkrim, të marra nga Ministria e punëve të brendshme, policia ka zbuluar autorët e të paktën 18 incidenteve. Për më së paku 23 incidente të tjera,

policia ka qenë e informuar dhe incidentet po hetohen. Një total prej 11 kallëzimesh penale u ngrit kundër më së paku 30 personave, kurse në 7 prej incidenteve, ndaj autorëve u ngritën akuza për kundërvajtje.

IX. DHUNA E BAZUAR NË GJINI

1. Hyrje

Gjatë vitit 2016, u regjistruan pesë raste të reja femicid - vrasje të grave nga bashkëshortët aktualë ose të mëparshëm, ose nga partnerët e tyre. Komiteti i Helsinkit me shqetësim përkujton se këto ngjarje janë vetëm një vazhdim i rasteve të shumta të dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje që kanë rezultuar me vdekje në dy vitet e fundit. Gjegjësisht, në prill të këtij viti, mediat raportuan për vrasje të dyfishtë dhe vetëvrasje në fshatin Vollkovë të Shkupit. Një polic 45-vjeçar së pari vrau nënën dhe gjyshen e dashnores së tij dhe më pas bëri vetëvrasje. Në gusht, u raportua për vrasje të një gruaje nga bashkëshorti i saj, i cili pastaj bëri vetëvrasje. Rasti ndodhi në Makedonska Kamenicë.

Kjo situatë është shqetësuese, veçanërisht nëse merret parasysh që shteti nuk ofron mbrojtje të veçantë për të gjitha format e dhunës me bazë gjinore, e as nuk mban evidencë të posaçme për rastet e femicideve. Këto kushte janë të përcaktuara në Konventën e Stambollit, që paraqet dokumentin e parë gjithëpërfshirës ndërkombëtar për mbrojtjen e grave nga dhuna, nënshkruese e të cilit është edhe Republika e Maqedonisë, por të njëjtin akoma nuk e ka ratifikuar.

Në periudhën raportuese, Komiteti i Helsinkit ofroi ndihmë juridike në 6 raste të dhunës me bazë gjinore dhe monitoroi veprimet e institucioneve, përfshirë gjykatat, të cilat duhet të shqiptojnë masa të përkohshme për mbrojtje nga dhuna në familje. Nga procedurat e monitoruara mund të konkludohet se institucionet ende nuk e njohin plotësisht Ligjin për parandalim, pengim dhe mbrojtje nga dhuna në familje, veçanërisht nenin që përcakton se edhe dhuna midis partnerëve që nuk jetojnë së bashku, konsiderohet dhunë në familje.

RASTE INDIVIDUALE:

Rasti 1. Dhuna në familje nga ana e prindërve

Komiteti të Helsinkit për të Drejtat e Njeriut iu drejtua një palë që kërkoi ndihmë juridike si viktimë e dhunës fizike dhe psikike në familje. Gjegjësisht, prindërit e palës, një periudhë më të gjatë, ushtrojnë dhunë fizike dhe psikike, duke e rrahur çdo ditë dhe duke e fyer me fjalë poshtëruese. Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut, për nevojat e palës, përgatiti një kërkesë për shqiptimin e masave të përkohshme për mbrojtje nga dhuna në familje dhe kërkesa iu dorëzua Gjykatës themelore kompetente. Në kërkesë, pala kërkoi nga Gjykata shqiptimin e të gjitha masave të parashikuara për mbrojtje të parapara në nenin 35 të Ligjit për parandalimin, pengimin dhe mbrojtjen nga dhuna në familje dhe caktoi përfaqësues / përfaqësuese të Komitetit të Helsinkit për të Drejtat e Njeriut të Republikës së Maqedonisë, i cili / e cila do ta shoqërojë në seancat gjyqësore për shqiptimin e masave të përkohshme.

Pas monitorimit të seancave të deritashme gjyqësore, Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut shpreh brengosje për faktin se gjyqtarët nuk e njohin si duhet Ligjin për parandalimin, pengimin dhe mbrojtjen nga dhuna në familje. Gjegjësisht, gjatë seancës kryesore, gjykatësi në çështjen e palës, deklaroi se “ligji nuk i jep atij autoritetin për të shqiptuar masa të përkohshme për të dërguar autorët e dhunës në familje në një qendër të përshtatshme këshillimi, dhe as që ka kompetenca ligjore për të larguar përkohësisht nga shtëpia, autorët e dhunës në familje”.

Ligji për parandalimin, pengimin dhe mbrojtjen nga dhuna në familje parashikon të gjitha masat për mbrojtje të përkohshme, përfshirë largimin nga shtëpia, pavarësisht nga pronësia (neni 35 paragrafi 4) dhe shkuarjen e detyrueshme në një qendër të përshtatshme këshillimi (neni 35 paragrafi 8). Njëkohësisht, neni 42 i të njëjtit Ligj, parasheh që gjykatat në procedura të vendosin për masa të përkohshme për mbrojtje dhe se në ato çështje zbatohen dispozitat e Ligjit për Procedurën Civile, nëse në Ligjin për parandalimin, pengimin dhe mbrojtjen nga dhuna në familje, nuk është paraparë ndryshe.

Rasti 2 - Dhuna në familje ndaj gruas nga bashkëshorti i saj

Komitetit të Helsinkit për të Drejtat e Njeriut iu drejtua një palë që kërkoi ndihmë juridike si viktimë e dhunës fizike dhe psikike në familje. Gjegjësisht, bashkëshorti i palës e ka keqtrajtuar fizikisht atë për një kohë të gjatë, duke e rrahur dhe fyer. Dhuna fizike ndaj palës ka arritur kulmin në 21 korrik 2016, kur ajo e ka pyetur bashkëshortin a i kishte kryer punët në fushë, pas së cilës burri i saj, pa ndonjë arsye, ka filluar ta fyejë, ta godasaë me shuplaka dhe ta shtrëngonte në qafë.

Përveç dhunës fizike, ndaj saj është përdorur edhe dhunë ekonomike dhe psikike. Gjegjësisht, bashkëshorti ia kishte ndaluar daljen nga shtëpia, lëvizjen e lirshme, përdorimin e telefonit, kartën e kreditit dhe të ngjashme. Për këto arsye, pala, përmes avokatit të saj, në Gjykatën Themelore Vinicë paraqiti propozim për shqiptimin e më shumë masave të përkohshme për mbrojtje nga dhuna në familje, duke bashkangjitur edhe gjithë dokumentacionin mjekësor për lëndimet trupore të shkaktuara nga bashkëshorti i saj. Gjykata Themelore Vinicë me vendim refuzoi propozimin e palës për shqiptimin e masave të përkohshme për mbrojtje nga dhuna në familje, në bazë të deklaratës së dhënë nga bashkëshorti i saj, duke mos e vlerësuar dokumentacionin e dorëzuar mjekësor. E pakënaqur me këtë vendim, pala paraqiti një ankesë në Gjykatën e Apelit në Shtip. Edhe më shqetësues është fakti që Gjykata e Apelit në Shtip e refuzoi ankesën me shpjegimin se pala nuk paraqiti prova se ekzistojnë arsye për përcaktimin e masave të kërkuara të përkohshme, edhe përkundër faktit se pala ka dorëzuar dokumentacionin e plotë mjekësor për lëndimet e pësura trupore.

Rasti 3 - Dhuna në familje nga ish-partneri

S.S. është viktimë e dhunës në familje nga partneri i saj me të cilin ka pasur një lidhje 15 - mujore. Për herë të parë S.S. e ka denoncuar dhunën pas një grindjeje verbale në një restorant në Strumicë, kur autori e ka thërritur që të dalin jashtë restorantit, ku ai ka filluar t'i bie me grushta dhe me shqelma në kokë dhe trup. Pas kësaj, të dy u dërguan në stacionin policor në Strumicë ku, pas një bisede të shkurtër, autori u la i lirë, kurse viktima u mbajt për 8 orë në stacionin policor. Oficerët e policisë nuk

e kanë informuar viktimën me të drejtat e saj, nuk i është lejuar të bëjë thirrje telefonike e as nuk i është thënë që ka të drejtë për avokat. Të njëjtën ditë, S.S. është lajmëruar në Shërbimin Emergjent Mjekësor në Shtip dhe ka denoncuar lëndime të shkaktuara nga kryerësi.

Pasi i janë bërë të gjitha egzaminimet mjekësore, S.S. denoncoi dhunë familjare në stacionin policor në Shtip. Atje, ajo ka folur me një oficer policie i cili i ka thënë se do ta thërrasin dhunuesin për bisedë verbale dhe do t'ia tërheqin vërejtjen. Pasi që pala nuk ishte e kënaqur me reagimin e oficerit, pas dy ditësh ajo përsëri e ka denoncuar dhunën në stacionin policor Shtip. Këtë herë ajo ka folur me një inspektor policor për dhunën në familje, i cili veprimi në përputhje me kompetencat e tij dhe e udhëzoi viktimën të shkonte në spital dhe të dokumentonte dëmtimet. Personat zyrtarë përgatitën një proces verbal për pranimin e ankesës për veprë penale të kryer "lëndim trupor" gjatë kryerjes së dhunës në familje.

Pas denoncimit të dhunës në Stacionin Policor Shtip, S.S. iu drejtua edhe Qendrës Ndër-Komunale për Çështje Sociale - Shtip, por personat zyrtarë i thanë asaj se ajo nuk mund të denoncojë rastin sepse nuk kishte të bënte me dhunë në familje. Nuk ndihmuan as fjalët e S.S. se rasti tashmë është raportuar në polici dhe atje trajtohet si shkaktim i lëndimit trupor gjatë kryerjes së dhunës në familje.

Komiteti i Helsinkit i siguroi ndihmë juridike personit S.S. që të paraqesë propozim për shqiptimin e masave të përkohshme për mbrojtje në Gjykatën Themelore Shtip, por Gjykata e refuzoi, si të pabazë, duke konsideruar se nuk ka rrezik për integritetin fizik, sigurinë dhe shëndetin e palës propozuese. Pas ankesës së dorëzuar në Gjykatën e Apelit Shtip kundër vendimit të Gjykatës themelore Shtip, Gjykata e Apelit e hodhi poshtë ankesën, si të pabazë.

X. KRIZA E REFUGJATËVE

Kriza e refugjatëve, e cila filloi në vitin 2014 dhe e tronditi tërë botën, nuk e zvogëloi intensitetin e saj edhe gjatë vitit 2015 dhe 2016. Republika e Maqedonisë u prek thellë gjatë gjithë krizës së refugjatëve, si një nga vendet tranzite të të ashtuquajturës “rruga Ballkanike”. Që nga fillimi i regjistrimit të refugjatëve që kanë kaluar nëpër territorin e shtetit e deri në fund të vitit 2015, janë regjistruar 388,233 refugjatë. Nga fillimi i vitit 2016, deri në mars 2016⁴, u regjistruan gjithsej 89,623 refugjatë, nga të cilët 35,381 janë meshkuj, 19,917 gra dhe 34,625 fëmijë, përfshirë 226 të mitur të pashoqëruar. Shumica e refugjatëve janë nga Siria, Afganistani dhe Iraku, por nuk përjashtohen edhe grupe dhe individë të rastit nga Pakistani, Irani, Maroku dhe Algjeri.

E ballafaquar me krizën e refugjatëve, e njëkohësisht edhe me krizën e vet shoqërore - politike, Republika e Maqedonisë, përmes akteve individuale ose praktike të vendosura, nuk arriti të sigurojë respektimin e të drejtave themelore të njeriut dhe liritë e refugjatëve që kalonin nëpër territorin e vendit, ose ngecën “të mbërthyer” në të, kundër vullnetit të vet.

Situata e krizës

Për shkak të fluksit të madh të refugjatëve që hynin nga ana e fqinjit jugor, me vendim të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë u shpall gjendje krize në kufirin jugor dhe verior, për herë të parë në gusht 2015. Situata e krizës u zgjat dy herë të tjera gjatë vitit, fillimisht deri në fund të vitit 2016, dhe pastaj me një vendim të ri në tetor, situata e krizës zgjati deri në fund të qershorit, 2017.

Mbyllja e kufijve

Nga fillimi i vitit 2016 deri në ditët e para të marsit, refugjatët kalonin nëpër territorin e vendit në mënyrë të organizuar dhe të koordinuar. Statistikat tregonin se midis 10 deri në 15,000 refugjatë tranzitonin gjatë javës. Gradualisht, numri filloi

4 Pak para mbylljes së kufijve të të gjitha vendeve të Rrugës Ballkanike, duke përfshirë edhe kufirin tonë.

të zvogëlohet. Më 7 Mars 2016, Republika e Maqedonisë vendosi të mbyllë kufijtë e saj me shpjegimin se ishte një reagim zinxhiror i mbylljes së kufijve nga vendet e tjera në Rrugën Ballkanike dhe vendet e Bashkimit Evropian. Ky vendim u marrë pasi ndërmjet Bashkimit Evropian dhe Turqisë u arrit një marrëveshje për zgjidhjen e krizës së refugjatëve, e përcjellë nga një seri masash që do të zbatohen me qëllim që të zvogëlohet ose ndalohej fluksi i refugjatëve⁵. Me këtë masë, në Republikën e Maqedonisë, rreth 1,500 refugjatë me origjinë nga Siria, Iraku dhe Afganistani, mbetën të “mbërthyer” në kufijtë jugorë dhe veriorë. Kjo praktikë paraqet shkelje të drejtpërdrejtë të të drejtës për qasje në territor, si dhe të të drejtës për të kërkuar azil.

Kampe tranziti

Megjithëse kampet e tranzitit në Gjevgjeli dhe Tabanovcë u ngritën gjatë kalimit të refugjatëve nëpër vend, qëllimi dhe përdorimi i tyre i vërtetë doli në pah gjatë vitit 2016. Jo rastësisht, kampet ishin të vendosura jashtë vendbanimeve, afër vijave kufitare me Greqinë (Vinojug, Gjevgjeli) dhe Serbinë (Tabanovcë, Kumanovë), pranë binarëve të hekurudhës. Ato azhurnoheshin dhe përmirësoheshin vazhdimisht. Me mbylljen e kufijve në fillim të marsit, në kampin e tranzitit Vinojug, Gjevgjeli, mbetën rreth 130 refugjatë dhe ky numër mbeti relativisht i njëjtë deri në fund të vitit. Ndërkaq, në kampin Tabanovcë, Kumanovë, mbetën rreth 1.500 refugjatë, me ç’rast 1.000 prej tyre ishin të vendosur brenda kampit, kurse rreth 400 refugjatë u gjetën jashtë kampit, në zonën ndërkufitare me Serbinë, në kushte të tmerrshme dhe nën qiell të hapur. Refugjatët që ndodheshin në kampin në Tabanovcë mund të lëviznin lirshëm dhe të largohen nga kampi në çfarëdo kohe. Kështu, me kalimin e kohës, numri i refugjatëve në kampin në Tabanovcë, ngadalë, por sigurtë zvogëlohej, për të arritur numrin 60-90 refugjatë deri në fund të vitit.

Përderisa kampi në Tabanovcë ishte i natyrës së hapur dhe refugjatët ishin të lirë të largohen dhe të kthehen, kampi në Vinojug ishte i karakterit të mbyllur, pra refugjatëve u kufizohej lëvizja e lirë. Kjo është shkelje e drejtpërdrejtë e të drejtave themelore të njeriut, kur merret parasysh se refugjatët mbaheshin në një lloj paraburgimi, pa pasur ndonjë vendim të shqiptuar nga ndonjë organ përkatës që

5 http://europa.eu/rapid/press-release_MEMO-16-963_en.pdf

i ndalon ose i privon nga liria, e as që ishte ngritur ndonjë akuzë për vepër penale ndaj tyre. Kjo situatë mbeti e pandryshuar deri në fund të vitit 2016.

Ndërkohë, megjithëse objektet e akomodimit në të dy kampet përmirësoheshin çdo ditë dhe bëheshin përpjekje për t'iu siguruar refugjatëve një jetë normale, ende kishte kufizime që i pengonin ata të gëzojnë plotësisht të drejtat e njeriut. Për shembull, dhomë lutjesh nuk kishte në asnjërin kamp, gjë që është në kundërshtim me të drejtën e tyre për religjionin dhe praktikimin e riteve fetare. E drejta për të kërkuar azil ishte e kërcënuar në shumë raste, duke pamundësuar qasje në procedurat e veprimeve për azil. Sa i përket shqyrtimit të kërkesave për azil, për të cilat zhvillohej procedurë, kërkesat shqyrtoheshin në mënyrë joadekuate dhe për to vendosej në procedurë të shkurtër, sipërfaqësore dhe jotransparente.

Kontrabanda

Një nga pasojat e pashmangshme të mbylljes së kufijve ishte prania e shtuar e kontrabandistëve dhe riaktivizimi i grupeve të kontrabandës. Sipas burimeve jozyrtare, grupet e kontrabandës ishin më aktive në rajonin e Kumanovës, përkatësisht në fshatrat përreth, Tabanovcë, Llojanë dhe Vaksincë. Sipas rrëfimeve të refugjatëve që arritën t'u shmangen grupeve të kontrabandës (ose nuk kishin para të mjaftueshme për të dalë nga shteti), grupet e kontrabandës nga Greqia ua dorëzonin refugjatët grupeve të kontrabandave në Republikën e Maqedonisë, të cilat më pas i shoqëronin refugjatët deri në Beograd, Serbi. Për këto shërbime, refugjatët paguanin shumën prej 1500 eurosh për person. Sipas dëshmive të refugjatëve, ndonjëherë edhe janë mbajtur peng, i kanë maltretuar dhe i kanë rrahur, derisa nuk i kanë paguar paratë për të vazhduar rrugën. Duke u bazuar në njohtimet e Ministrisë së punëve të brendshme, Komiteti i Helsinkit ka shënuar rreth 37 raste të natyrës juridike - penale në lidhje me migracionin e paligjshëm dhe kontrabandën e migrantëve, në periudhën nga qershori deri në dhjetor. Ngjarjet u zhvilluan me dinamikë të ndryshme, përkatësisht ndonjëherë janë gjetur pesë grupe të kontrabandës brenda një jave, e ndonjëherë asnjë. Kontrabandistët nganjëherë janë zënë, por në të shumtën e rasteve kanë shpëtuar dhe janë të paarritshëm për autoritetet.

Dëbimi i paligjshëm

Në pamundësi për t'i bërë ballë kushteve të mjerueshme dhe çnjerëzore në kampet në Idomeni, Greqi, dhe në shenjë revolte për mbylljen e kufijve nga vendet përgjatë Rrugës Ballkanike, në 14 Mars 2016, rreth 700 refugjatë kaluan në mënyrë të paligjshme kufirin e Maqedonisë me Greqinë, në afërsi të fshatit Moin, rajoni i Gjevgjelisë. Pjesëtarët e policisë dhe ushtrisë maqedonase të vendosur përgjatë kufirit jugor reagon menjëherë duke përdorur gaz lotsjellës dhe bomba tymi. Pas një periudhe të shkurtër, të gjithë refugjatët që kaluan kufirin u vendosën në kamionë dhe u transportuan në territorin Grek, larg çdo dëshmie. Në përpjekje për të shpëtuar, tre refugjatë (dy burra dhe një grua shtatzënë) humbën jetën duke u mbytur në ujërat e Suva Reka. Pas mbylljes së kufijve dhe pamundësisë së lejimit të hyrjes së refugjatëve, organet e sigurisë vendosën një praktikë shqetësuese të “dëbimit të paligjshëm” të refugjatëve drejt Greqisë. Gjegjësisht, të gjithë refugjatët që u gjetën në rrugë ilegale në të gjithë vendin, ose si viktima të kontrabandistëve, u “deportuan” në territorin Grek, në një mënyrë të parregulluar, të paligjshme dhe të fshehtë, u ngarkuan në kamionë dhe u lëshuan nën telat me gjemba të vendosura në vijën kufitare. Përkaj metodës jashtëzakonisht çnjerëzore dhe johumane të zbatuar, kjo praktikë paraqet shkelje të drejtpërdrejtë të Nenit 4 të Protokollit Nr. 4 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, i cili në mënyrë eksplicite ndalon dëbimin kolektiv të të huajve. Përmes praktikës së vet, Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut shpjegon se kjo do të ishte e lejueshme vetëm nëse shteti i ka shqyrtuar rrethanat individuale të secilit individ në grup. Përveç bisedave të herëpashershme me grupe të caktuara në kampin e tranzitit të Gjevgjelisë, sigurisht që shteti nuk e praktikonte shqyrtimin individual të rasteve. Nga vëzhgimet e Komitetit të Helsinkit, konkludohet se grupet e dëbuara numërojnë nga 30, ndonjëherë edhe deri në 300 refugjatë. Në një paraqitje zyrtare, Presidenti i Republikës së Maqedonisë me krenari deklaroi se shërbimet maqedonase të sigurisë kanë parandaluar hyrjen e paligjshme të më shumë se 18,000 migrantëve, pa bërë me dije se një veprim i tillë është në kundërshtim të plotë me Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe paraqet një dëbim kolektiv të të huajve.

Krime nga urrejtja ndaj refugjatëve

Gjatë gjithë krizës së refugjatëve, qëndrimi i popullsisë së vendit ndaj refugjatëve sillej nga mbështetja e fortë dhe dëshira për të ndihmuar, deri tek përhapja e gjuhës së urrejtjes dhe neverisë ndaj refugjatëve. Gjëja më e frikshme është se nuk munguan edhe sulmet e drejtpërdrejta mbi refugjatët, përkatësisht kryerja e krimeve të urrejtjes për shkak të statusit të refugjatit, gjë që u vu re në disa raste.

Gjatë monitorimit, në platformën www.zlostorstvaodomraza.mk, Komiteti i Helsinkit regjistroi 11 sulme, veprime urrejtjeje të kryera nga qytetarët e Maqedonisë ndaj refugjatëve. Sulmet më së shpeshti përfshijnë grabitje të refugjatëve, duke ua marrë paratë dhe gjithçka që posedojnë. Nuk përjashtohet edhe shkaktimi i lëndimeve të lehta ose të rënda trupore, përdorimi i forcës fizike ose sulm me thikë. Komiteti i Helsinkit thekson faktin se, megjithëse shpesh akuzohen për dhunë, refugjatët asnjëherë nuk kanë kryer një akt dhune ose sulmi ndaj shtetasve maqedonas.

Megjithëse Rruga Ballkanike për tranzitim të refugjatëve është zyrtarisht e mbyllur, kriza e refugjatëve nuk është as afër përfundimit. Fati i refugjatëve nëpër kampet e tranzitit në Republikën e Maqedonisë, si dhe i refugjatëve që kalojnë ilegalisht nëpër territorin e shtetit, është akoma i pasigurt. Republika e Maqedonisë dështoi në menaxhimin e krizës së refugjatëve, sepse nuk arriti të mundësojë respektimin e të drejtave dhe lirive themelore të tyre në çdo kohë.

XI.PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME

TË DREJTAT QYTETARE DHE POLITIKE

Përfundim:

Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut konstatoi se policia në mënyrë të pabazë kufizonte të drejtën për protestë në një pjesë të tubimeve publike, duke mos i lejuar qytetarët të lëvizin lirshëm në rrugë dhe të protestojnë para institucioneve të caktuara. Duke vepruar kështu, oficerët e policisë kufizonin të drejtën për lëvizje të lirë, por në të njëjtën kohë edhe të drejtën për tubim publik, që parashihet si vepër penale në Kodin Penal.

Rekomandim:

Komiteti i Helsinkit konsideron që në të ardhmen, policia nuk guxon të kufizojë të drejtën për të protestuar, duke pasur parasysh që kjo paraqet vepër penale. Prokuroria Publike, në rastet e kufizimit ose pengimit të një tubimi publik, duhet të veprojë sipas detyrës zyrtare dhe të fillojë procedurat, sipas detyrës zyrtare, për konstatimin e përgjegjësisë penale për shkelje të së drejtës për protestë, por edhe të të drejtave dhe lirive të njeriut.

GJYQËSORI

Përfundim:

Në vitin 2016, problemet me të cilat në të kaluarën ballafaqohej sistemi i drejtësisë, u thelluan edhe më tepër. Shkaktar kryesor i kësaj situatë ishte kriza politike. Organet, që me Kushtetutë ishin të parapara për të siguruar dhe garantuar mëvetësinë dhe pavarësinë e Gjyqësorit dhe kryerjen e funksionit të Prokurorisë publike, vazhduan të vepronë si ekzekutues të dëshirave dhe urdhërave të partive politike në pushtet. Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut konfirmoi se Këshilli Gjyqësor nuk është një institucion i pavarur dhe i paanshëm, kurse kryetari i Këshillit të Prokurorëve Publikë u rizgjodh, pavarësisht pengesës së qartë ligjore për marrjen e një mandati të dytë. Përpërimi i profesionalitetit në Gjyqësor dhe Prokurori u ngadalësua si pasojë e procedurave joefikase për zgjedhjen e kandidatëve për trajnimin fillestar

në Akademinë për Gjyqtarë dhe Prokurorë publikë. PSP-ja hapi procedura para-hetimore kundër 112 personave dhe 50 persona ishin subjekt i procedurave hetimore. Megjithatë, që nga themelimi, kjo Prokurori po përballlet me pengesa dhe sabotime nga më shumë institucione shtetërore, bashkëpunimi i të cilave është thelbësor për arritjen e rezultateve të pritura. Gjykata Themelore Shkupi 1 kryesoi në pengimin e punës së PSP-së. Gjykata hodhi poshtë pothuajse të gjitha kërkesat për paraburgim dhe masat parandaluese të kërkuara nga PSP-ja, kurse u bënë edhe shpërndarje të diskutueshme të gjyqtarëve, që sinjalizon për joobjektivitet gjatë vendosjes së gjyqtarëve “të përshtatshëm”, të cilët do të ngadalësonin ose pengonin punën e PSP-së.

Rekomandim:

Komiteti i Helsinkit rekomandon ndryshime në Ligjin për Këshillin Gjyqësor, me përfshirje të plotë të opinionit të ekspertëve dhe forcimin e përbërjes së Këshillit Gjyqësor me ekspertë të pavarur, me çka do të mundësohet besim më i madh në vendimet e Këshillit Gjyqësor dhe Gjyqësorit në tërësi. Ligji aktual mbi Këshillin për verifikimin e fakteve duhet të shfuqizohet. Në të ardhmen, Akademia dhe gjykatat administrative duhet të respektojnë në mënyrë konsekuente afatet e shkurtra ligjore për parashtrësat, ankesat dhe paditë të përcaktuara në Ligjin për Akademinë për Gjyqtarët dhe Prokurorët publik, synimi i të cilëve është të sigurojnë efikasitetin e procedurës për përzgjedhjen e kandidatëve për Akademi. Institucionet të bashkëpunojnë me PSP-në dhe t’i dorëzojnë të gjitha dokumentet dhe informatat e nevojshme për të mundësuar zhvillimin e hetimeve kundër të gjithë personave të dyshuar dhe nisjen e procedurave përkatëse penale. E domosdoshme është zgjatja e afatit ligjor prej 18 muajsh për ngritjen e aktakuzave dhe propozimeve. Duhet bërë ndryshime në Ligjin për mbrojtjen e dëshmitarëve, nëpërmjet të cilave do të mundësohej PSP-ja të ketë të drejtë të propozojë dëshmitarë të mbrojtur në rastet në të cilat ka juridiksion.

KUSHTETUTA DHE LEGJISLACIONI

Përfundim:

Në vitin 2016, vazhdoi pasiviteti i pazakontë në punën e Gjykatës Kushtetuese. Besimi i qytetarëve u zvogëlua dhe ekzistonte një anim i qartë ndaj politikave të pushte-

tit legjislativ dhe ekzekutiv. Me këtë janë shkelur seriozisht pavarësia, paanshmëria, kompetenca dhe legjitimiteti i Gjykatës Kushtetuese.

Me faljen e 56 të akuzuarve, përfshirë edhe funksionarë të lartë shtetërorë dhe partiakë të pushtetit, Presidenti e vuri veten mbi ligjin, mbi Parlamentin dhe mbi marrëveshjen politike të Përzahinos, me çka në mënyrë serioze e pengoi punën e PSP-së. Falja, e cila në thelb ishte amnisti, është ndoshta shembulli i vetëm në histori ku një kryetar shteti fal një shkelje masive dhe të organizuar të të drejtave dhe lirive të njeriut, që përfshijnë raste të shkeljes të së drejtës kushtetuese për lirinë e zgjedhjes, shkeljen e privatësisë, korrupsion dhe abuzime të tjera të elitës politike.

Rekomandim:

Komiteti i Helsinkit i bën thirrje Gjykatës Kushtetuese që të ngrihet mbi interesat partiake dhe individuale dhe të marrë një vendim me të cilin nuk do të konstatojë moskushtetutshmëri të ligjit dhe nuk do ta shfuqizojë ose anulojë atë. Theksojmë edhe një herë se me këtë nuk do të lejohet mundësia që personat e dënuar për mashtrime zgjedhore të mund të falen, me çka do të mbrohet interesi shoqëror dhe shtetëror dhe do të sigurohet hapësirë për të rindërtuar sigurinë juridike dhe sundimin e të drejtës, si vlera themelore të rendit kushtetues të Republikës së Maqedonisë.

Komiteti i Helsinkit rekomandon që Presidenti në të ardhmen të përmbahet nga ndërmarrja e veprimeve dhe vendimeve që rrezikojnë sigurinë juridike dhe sundimin e të drejtës në Republikën e Maqedonisë, e të cilat përbëjnë akt të rrëzimit të shtetit juridik dhe shkelje të detyrimeve ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, të ratifikuara nga Republika e Maqedonisë.

INSTITUCIONET E MBYLLURA DHE MALTRETIMI

Përfundim:

Gjatë vitit 2016 dhe fillimit të vitit 2017, 13 persona të dënuar vdiqën në burgjet e Maqedonisë. Shumica e tyre po vuanin dënimin në Burgun Idrizovë. Nuk u morën kurrfarë masash për të adresuar nivelin e lartë të korrupsionit midis shërbimeve të burgjeve dhe të burgosurve. Dhuna nga shërbimet e burgut vazhdon, në formën e

shuplakave, grushtave, shqelmave dhe goditjeve me shkopinj. Autoritetet e burgjeve vazhduan të vonojnë në mënyrë të panevojshme procesin e mjekimit të të dënuarve dhe dërgimin e tyre për trajtim mjekësor, një situatë që është e dëmshme për shëndetin e këtyre personave, duke shkelur të drejtën e tyre të garantuar ligjërisht për mbrojtje shëndetësore. Shumica e personave të dënuar fare nuk kanë njohuri për mundësinë e marrjes së ndihmës juridike në burgje, kurse sistemi i ankesave dhe parashtresave deri te drejtorët e burgjeve, është plotësisht jofunksional. Edhe pse projekti për rikonstruimin dhe ndërtimin e burgjeve duheshte të përfundojë në 2015, aktivitetet ndërtimore në 2016 nuk ishin as afër përfundimit. Mekanizmat e mbikëqyrjes janë vetëm pjesërisht funksionale dhe nuk mund të konsiderohen të pavarura. Administrata vazhdimisht ka refuzuar të lejojë OJQ-të dhe mediat t'i vizitojnë burgjet dhe të flasin me personat e dënuar.

Edhe në vitin 2016, ashtu si në periudhën 2009-2015, nuk u shqiptua asnjë dënim me të cilin ndokush do të dënohej me burg për vepër penale torturë. Romët vazhdojnë të jenë viktimat më të shpeshta të torturave dhe keqtrajtimit nga policia dhe policia e burgjeve. Shteti ende nuk siguron mbështetje të përshtatshme ligjore, mjekësore, psikologjike dhe sociale për viktimat e torturave dhe trajtimit çnjerëzor.

Rekomandim:

Është koha e fundit që të përshpejtohen aktivitetet e parashikuara në Projektin e Rindërtimit të Burgjeve. Mbrojtja shëndetësore dhe ndihma juridike duhet të sigurohen sa më shpejt dhe në kushte të barabarta për të gjithë personat e dënuar. Mbikëqyrja administrative dhe gjyqësore duhet të përforcohet. OJQ-ve dhe mediave duhet t'u lejojë të vizitojnë lirshëm burgjet dhe të raportojnë për kushtet e jetesës.

Komiteti i Helsinkit u bën thirrje autoriteteve që më në fund të njohin ekzistencën e torturës dhe të zhvillojnë politika të mbrojtjes nga ky akt barbar. Autoritetet duhet të zbatojnë një politikë të tolerancës zero për aktet e torturës nga ana e personave zyrtarë. Është koha e fundit që të ballafaqohemi me fenomenin e mosndëshkimit dhe solidaritetit të prokurorive dhe gjykatave me policinë. Fokusi kryesor duhet të orientohet drejt viktimave të torturës, për të cilat shteti ende nuk siguron mbrojtje të përshtatshme juridike, mjekësore, psikologjike dhe sociale.

Urgjentisht duhet të rritet numri i mjekëve specialistë, përfshirë edhe praninë e

përhershme të internistëve (mjek i përgjithshëm, gjinekolog dhe dentist) në Entin Special Demir Kapi, të cilët në vazhdimësi do të përcillnin gjendjen shëndetësore të pacientëve, në mënyrë që pacientët të kenë mundësi t'i realizojnë të gjitha të drejtat e sigurimit shëndetësor.

DISKRIMINIMI

Përfundim:

Bazuar në të gjitha informatat nga institucionet kompetente për mbrojtjen e qytetarëve nga diskriminimi dhe rastet që u raportuan në Komitet, mund të konkludohet se, edhe përkundër faktit që kanë kaluar gjashtë vjet nga implementimi i Ligjit për ndalimin dhe mbrojtjen nga diskriminimi dhe formimit të Komisioni për mbrojtje nga diskriminimi, ende nuk mund të flitet për mbrojtje efektive në fushën e diskriminimit, veçanërisht kur bëhet fjalë për grupet e marginalizuara. Pikat kryesore lidhur me qasjen në drejtësi për viktimat e diskriminimit, përkatësisht përjashtimi nga shpenzimet gjyqësore për fillimin e procedurave gjyqësore për mbrojtje nga diskriminimi, pavarësia e Komisionit për mbrojtje nga diskriminimi, mostransferimi i barrës së provës në anën e diskriminuesit dhe mos përfshirja e orientimit seksual dhe identiteti gjinor si bazë për diskriminim, kanë mbetur të pandryshuara.

Të dhënat se mbrojtja gjyqësore në rastet e diskriminimi ka filluar të shfrytëzohet gjithnjë e më shumë, është një tregues i rritjes së vetëdijësisimit të qytetarëve për mundësitë e mbrojtjes gjyqësore. Megjithatë, shumica e procedurave gjyqësore të filluara, mbështeten nga shoqatat e qytetarëve që ofrojnë ndihmë juridike në rastet e diskriminimit, për arsye se Ligji për parandalimin dhe mbrojtjen nga diskriminimi nuk mundëson lirim nga shpenzimet gjyqësore gjatë inicimit të procedurave gjyqësore. Për këto arsye, mund të konstatohet se aksesit në drejtësi për mbrojtje gjyqësore nga diskriminimi, mbetet i kufizuar.

Rekomandim:

Urgjentisht duhet të ndryshojë Ligji për parandalimin dhe mbrojtjen nga diskriminimi në mënyrë që të lehtësohet qasja në drejtësi për viktimat e diskriminimit, pavarësi e Komisionit për mbrojtje nga diskriminimi, zhvendosja e barrës së provës tek diskriminuesi dhe përfshirja e orientimit seksual dhe identiteti gjinor si baza për diskriminim

Në periudhën e ardhshme, Qeveria dhe Parlamenti i Republikës së Maqedonisë duhet t'i pranojnë të gjitha ndryshimet në Ligjin për parandalimin dhe mbrojtjen nga diskriminimi, të propozuara nga grupi punues i themeluar nga Ministria e punës dhe politikës sociale, në mënyrë që përfundimisht të përmirësohet korniza ligjore për mbrojtje nga diskriminimi.

TË DREJTAT EKONOMIKE DHE SOCIALE

Përfundim:

Konstatim i përgjithshëm është se institucionet nuk veprojnë në pajtim me dispozitat ligjore pozitive dhe nuk i respektojnë afatet ligjore për përgatitjen e vendimeve, dhe me një mosveprim të tillë ato rrezikojnë drejtpërsëdrejti të drejtat e qytetarëve që burojnë nga ligjet për mbrojtje sociale dhe shëndetësore.

Qendrat për Punë Sociale, si një shërbim publik i qytetarëve, veçanërisht kur bëhet fjalë për lehtësimin e qasjes në realizimin e të drejtave sociale të qytetarëve që ndodhen në rrezik social, dështojnë në punën e tyre. Shfrytëzuesit e të drejtave të mbrojtjes sociale shpesh janë ballafaquar me vendime, me të cilat u ndërpritën disa të drejta, pikërisht për shkak të mosinformimit në lidhje me raportimin e ndryshimeve financiare të llogarive të transaksioneve dhe, si pasojë, për shkak të shërbimeve profesionale jofunksionale pranë qendrave për punë sociale. Kështu, shpesh ndodhte që të ndërpritet e drejta për ndihmë financiare sociale, pavarësisht se shumica e mjeteve të marra, e të padeklaruar, ishte e vogël. Përkundër procedurave të filluara të ankimit dhe procedurave para Gjykatës Administrative, qytetarët ende kanë pengesa në realizimin e të drejtave të tyre ekonomike dhe sociale për shkak të procedurave të gjata dhe funksionimit joefektiv të institucioneve.

Rekomandim:

Komiteti i Helsinkit rekomandon që organet shtetërore të udhëhiqen nga parimi i efikasitetit dhe verifikimit të së vërtetës materiale, si dhe të veprojnë në përputhje me udhëzimet e Gjykatës Administrative dhe Gjykatës së Lartë Administrative. Nga ana tjetër, gjykatat duhet të udhëhiqen nga parimi i efikasitetit dhe të drejtës për gjykim brenda një afati të arsyeshëm dhe të marrin vendime meritore në rastet kur rekomandimet e tyre nuk respektohen dhe nuk zbatohen nga ana e organeve drejtuese.

GJUHA E URREJTJES

Përfundim:

Edhe pse gjuha e urrejtjes po merr hov gjithnjë e më të madh në shoqëri dhe po bëhet një mjet i zakonshëm për pastrimin e llogarive të grupeve dhe individëve të ndryshëm, reagimi i organeve shtetërore, që janë përgjegjëse për ndjekjen penale të urrejtjes, është diametralisht i kundërt, pothuajse inekzistent. Një nga faktorët inkurajues për përhapjen e gjuhës së urrejtjes është pikërisht mosndëshkimi dhe toleranca ndaj kësaj dukurie. Faktor tjetër është prezenca e gjuhës së urrejtjes nga ana e personave publik, të cilët në vend që të dënojnë dhunën dhe intolerancën, e nxisin atë në mënyrë të konsiderueshme, pa mbajtur asnjë përgjegjësi ligjore ose shoqërore.

Rekomandim:

Është e domosdoshme të parashihet vepër penale - përhapje e gjuhës së urrejtjes, nga e cila do të rezultojë një përkufizim i plotë për atë se çfarë paraqet gjuha e urrejtjes dhe të parashihet një listë e mbyllur e karakteristikave. Shteti dhe organizatat e shoqërisë civile duhet të punojnë në mënyrë të konsiderueshme për të rritur vetëdijen e qytetarëve për ekzistencën e gjuhës së urrejtjes, si dhe për mekanizmat për mbrojtje dhe raportimin e gjuhës së urrejtjes. Është e domosdoshme që policia, prokuroritë publike dhe gjykatat të tregojnë një qëndrim të qartë dhe tolerancë zero ndaj gjuhës së urrejtjes, si një vepër penale. Kryerësit e veprave penale duhet të dënohen me gjobat e duhura. Personat publik, udhëheqësit politikë dhe subjektet relevante shoqërore duhet të marrin një qëndrim të ashpër, unanim, kundër gjuhës së urrejtjes dhe ta promovojnë atë para opinionit dhe grupeve tek të cilat kanë ndikim.

KRIME NGA URREJTJA

Përfundim:

Në vitin 2016, janë regjistruar 70 vepra të urrejtjes. Krahasuar me vitin 2015, dallimi në vitin 2016 qëndron në motivin e incidenteve të urrejtjes. Përderisa në vitin 2015 motivi për shumicën e incidenteve ishte statusi i refugjatit ose migrantit, i

personave që kalonin nëpër territorin e Republikës së Maqedonisë, në vitin 2016 motivi për shumicën e incidenteve është përkatësia etnike, përkatësisht përkatësia politike ose bindjet e viktimave dhe autorëve. Zgjedhjet e parakohshme parlamentare dhe negativiteti që rezultoi nga kriza politike, ishin shkaktarë të veçantë të krimeve të urrejtjes. U regjistruan të paktën 89 viktima dhe 211 autorë të krimeve nga urrejtja. Shumica e viktimave janë të rinj dhe refugjatë ose migrantë.

Rekomandim:

Sipas Komitetit të Helsinkit ekziston lidhje e drejtpërdrejtë midis gjuhës së urrejtjes në hapësirën publike dhe krimeve të regjistruara të urrejtjes. Aktet e urrejtjes në periudhën parazgjedhore shfaqen si pasojë e drejtpërdrejtë e pranisë së shtuar të gjuhës së urrejtjes tek figurat publike në media, në fushatat politike dhe në tubimet e partive politike. Komiteti u bën thirrje përfaqësuesve politikëve dhe figurave të tjera publike, jo vetëm të përmbahen nga përdorimi i gjuhës së urrejtjes, por edhe të dënojnë ashpër përdorimin e saj.

DHUNË MBI BAZA GJINORE

Përfundim:

Shteti ende nuk i përmbush standardet minimale që duhet të garantojnë mbrojtje efektive nga dhuna ndaj grave. Mungesa e reagimit përkatës nga ana e policisë dhe qendrave për punë sociale, numri i vogël i qendrave për strehimin e viktimave të dhunës në familje, mungesa e qendrave për strehimin e viktimave të dhunës seksuale, janë vetëm disa nga problemet e sistemit, për arsye të të cilave mund të konkludohet se shteti nuk i plotëson kushtet për sigurimin e mbrojtjes së drejtë të grave - viktima të dhunës mbi bazë gjinore. Sa i përket veprimit të gjyqeve, u vërejt se gjyqtarët nuk janë plotësisht të informuar me përmbajtjen e Ligjit për parandalimin, pengimin dhe mbrojtjen nga dhuna në familje, dhe si pasojë e kësaj, në raste të caktuara nuk u shqiptuan masa të parakohshme për mbrojtje nga dhuna në familje.

Rekomandim:

Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut rekomandon që gjyqtarët të fillojnë të zbatojnë në mënyrë efektive, të qëndrueshme dhe korrekte Ligjin për parandalimin, pengimin dhe mbrojtjen nga dhuna në familje, veçanërisht dispozitat në lidhje me shqiptimin e masave të përkohshme të mbrojtjes, në mënyrë që të sigurohet mbrojtje më e mirë dhe të eliminohen rreziqet e drejtpërdrejta dhe serioze për jetën dhe integritetin fizik të viktimave të dhunës në familje dhe anëtarëve të familjes së tyre. Shteti, sa më shpejt, duhet të fillojë procesin e ratifikimit të Konventës së Stambollit dhe të sigurojë standarde minimale për mbrojtjen efektive të grave dhe të fëmijëve viktimë të dhunës.

KRIZA E REFUGJATËVE

Përfundim:

Gjatë krizës së refugjatëve, u vërejt një shkelje e konsiderueshme e të drejtave të refugjatëve në territorin e Republikës së Maqedonisë. Duke filluar që nga mbyllja e kufijve, me çka u kufizua liria e tyre e lëvizjes dhe mundësia për dorëzimin e kërkesës për azil në një vend të zgjedhur prej tyre, përmes trajtimit çnjerëzor dhe degradues nga ana e personave zyrtarë, e deri te moskryerja e hetimeve efektive për jetët e humbura të njerëzve, shteti nuk arriti të përmbushë detyrimet që dalin nga dokumentet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, nënshkruese e të cilave është. Niveli i lartë i pranisë së diskriminimit, gjuhës së urrejtjes dhe akteve të urrejtjes, treguan se shoqëria është e mbyllur dhe e papërgatitur për një qasje humane ndaj personave me origjinë emigrante. Për më tepër, paaftësia e shtetit për t'i hetuar dhe sanksionuar ato, tregoi një mosfunksionim serioz të mekanizmave vendorë për mbrojtjen e të drejtave themelore.

Rekomandim:

Legjislacioni kombëtar në lidhje me të drejtat e refugjatëve ose azilkërkuesve, duhet të konsolidohet edhe në përputhje me të drejtën ndërkombëtare dhe dokumentet për mbrojtje të të drejtave të njeriut, nënshkruese e të cilave është shteti. Të gjitha rastet ku ka pretendime për shkelje të të drejtave të njeriut, për të gjithë njerëzit në territorin e Republikës së Maqedonisë, duhet të hetohen në mënyrë adekuate dhe efektive nga ana e shtetit dhe personat përgjegjës duhet të sanksionohen. Të

drejtat themelore njerëzore të refugjatëve duhet të promovohen, të respektohen dhe mbrohen në çdo moment gjatë qëndrimit të tyre në Republikën e Maqedonisë. Refugjatëve që tranzitojnë nëpër territorin e vendit, nuk guxon t'u ndalohet e drejta për të kërkuar azil, duke mos u lejuar qasje në procedurën për azil.



RAPORT VJETOR

për gjendjen e të drejtave të njeriut të anëtarëve
të komunitetit LGBTI në vitin 2016

FITIMI I LIRISË

PËRMBAJTJA:

Hyrje	72
Avokim	72
Institucionet	74
Mediumet dhe komunitetit LGBTI	76
Rastet	78
Komuniteti	78



1. Hyrje

Viti i kaluar shënoi kulmin e luftës për fitimin e lirisë dhe hapësirës, të cilat vite me rradhë u uzurpuan nga një klikë totalitare dhe kriminele, e vendosur në pushtet. E kemi mbështetur këtë luftë, me qëllim që të sigurohen kushte të drejta për angazhimet tona për një trajtim të drejtë dhe të barabartë. Qëllimi ishte të sigurojmë një hapësirë demokratike dhe të lirë në të cilën mund t'i shprehim argumentet tona për një shoqëri ndryshe, shoqëri të drejtë dhe humane që do të kujdeset për të gjithë, pa përjashtim. Lufta për të rifituar lirinë dhe hapësirën e uzurpuar na çon drejt mundësisë së vetme për të riformuluar shoqërinë tonë këtë vit, si dhe në vitet përpara nesh. Nuk guxojmë ta humbasim shansin për të ndërtuar një shoqëri të hapur dhe të drejtë, në mënyrë që të arrijmë deri te qëllimi: **TË NDRYSHËM! TË BARABARTË! TË LIRË!**

2. Avokim

Gjatë vitit 2016, një pjesë e madhe e aktiviteteve të Qendrës për përkrahje LGBTI ishin të kushtëzuara nga situata politike e komunitetit më të gjerë politik, dhe jo vetëm nga situata në të cilën zhvillohej jeta e personave LGBTI në Maqedoni. Prandaj, artikulumet kryesore politike, veçanërisht të përqëndruara përmes “Revolucionit shumëngjyrësh”, vendosën edhe pozicionin politik të LGBTI Qendrës për përkrahje.

Në këtë drejtim, një nga burimet kryesore, ishte hulumtimi nga i cili rezultoi Analiza e problemeve dhe nevojave të komunitetit LGBTI në Maqedoni. Qendra për përkrahje LGBTI, me ndihmë të pjesërishme të Ambasadës së SHBA-ve në Maqedoni, në janar të vitit të kaluar bëri një hulumtim mbi nevojat e personave LGBTI në Republikën e Maqedonisë, në fushat e mbrojtjes sociale, shërbimeve ligjore dhe veprimeve të policisë. Kërkimi nuk është bërë në një ekzemplar përfaqësues, dhe as që synon të paraqesë një fotografi për atë si e percepton i tërë komuniteti LGBTI vendin e vet në shoqëri. Kërkimi është një pikë fillestare për mënyrën se si personat LGBTI i perceptojnë institucionet. Sondazhit iu përgjigjën 134 të anketuar që jetojnë në Shkup, Tetovë, Kumanovë, Prilep, Manastir dhe Strumicë. Rezultatet e sondazhit

anonim treguan shifra frapante për besimin e komunitetit në institucione.

Gjithashtu, në përputhje me luftën kundër drejtësisë selektive, kundër të cilës u pozicionua e gjithë opozita në Maqedoni, jo vetëm komuniteti LGBTI, Qendra për përkrahje LGBTI hapi webfaqen www.prijavinasilstvo.mk, një faqe ku personat LGBTI në mënyrë anonime, mund të raportojnë rastet e dhunës ndaj tyre. Nevoja për ekzistimin e kësaj web faqeje, qëndron në faktin se sistemi në Maqedoni nuk funksionon dhe nuk mbron komunitetin LGBTI. Prezentimi i web faqes u bë para Prokurorisë Publike, në shenjë proteste kundër injorimit shumëvjeçar të rasteve të dhunës ndaj njerëzve dhe aktivistëve LGBTI. Asambleja Parlamentare e Këshillit të Evropës gjithashtu foli kundër drejtësisë selektive ndaj komunitetit LGBTI në shoqërinë maqedonase, duke miratuar Deklaratën nr. 585 mbi dështimin e autoriteteve maqedonase për t'iu përgjigjur sulmeve të përsëritura ndaj Qendrës për përkrahje LGBTI në Shkup. Deklarata përkujton gjashtë sulmet ndaj Qendrës për përkrahje LGBTI dhe aktivitetet përgjatë dy viteve të ekzistimit të saj dhe u bën thirrje autoriteteve në Republikën e Maqedonisë të dënojnë publikisht dhunën; të bëjnë gjithçka që është në fuqinë e tyre, që organet e zbatimit të ligjit të reagojnë shpejt dhe në mënyrë efektive ndaj incidenteve; të ndër marrin masa shtesë me qëllim të zgjidhjes së problemeve siç janë homofobia dhe transfobia në shoqëri, siç parashikohet në Rekomandimin e Komitetit të Ministrave CM / Rec (2010) 5 - në pjesën për masat në luftën kundër diskriminimit të bazuar në orientimin seksual ose identitetin gjinor.

Nga aspekti i lirisë së bashkimit dhe nevojës për spikatje të kërkesave të komunitetit LGBTI në sferën publike, është e rëndësishme të përmendet organizimi i fundjavës së katërt të Krenarisë. Qëllimi i një varg ngjarjeve në suaza të “Fundjavës së krenarisë Shkup 2016” ishte të krijonte dhe promovonte një botëkuptim tjetër dhe të ofronte një kritikë radikale dhe të shumëfishtë të sistemit binar gjinor, heteronormativitetit dhe homofobisë nacionaliste. Ideja bartëse e “Fundjavës së Krenarisë” të vitit të kaluar, ishte solidariteti. Për më tepër, organizimi i qëndrueshëm i Marshit të Tolerancës nga ana e Komitetit të Helsinkit për të Drejtat e Njeriut i Republikës së Maqedonisë, këtë vit iu kushtua luftës kundër gjuhës së urrejtjes, si dhe dhunës që përmban ky fjalor inkriminues, i cili prodhon lëndime dhe trauma në masë të madhe edhe për njerëzit LGBTI.

Lufta për një shoqëri të lirë nënkupton përgjegjësi dhe angazhim politik që ofron zgjidhje për arritjen e drejtësisë dhe barazisë. Bazuar në këtë konstatim, Qendra për përkrahje LGBTI në dhjetor të vitit të kaluar iu bashkangjiti procesit të përpilimit të një dokumenti për përmirësimin e situatës në disa sektorë. Procesi u mbështet nga zyra e Fondacionit Friedrich Ebert në Maqedoni, dhe u quajt “Dita pas”. Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut dhe Qendra e Mbështetjes LGBTI punuan në pjesën e gjyqësorit, të drejtave LGBTI dhe të drejtave themelore dhe demokracisë, ku bëjnë pjesë të drejtat fundamentale, e drejta e bashkimit, liria e shprehjes, entet e ndëshkimit e rehabilitimit, por edhe grupet e prekshme.

I njëjti dokument pastaj iu dha për nënshkrim përfaqësuesve të partive pjesëmarrëse në zgjedhjet e parakohshme parlamentare. Gjithashtu, duke u nisur nga nevoja për decentralizimin e angazhimit të tillë politik përmes të cilit duhet të arrihet deri te drejtësia dhe barazia në shoqëri, më 14 dhjetor, në mjediset e Avokatit të Popullit të Republikës së Maqedonisë, u nënshkrua një Memorandum Bashkëpunimi midis Komitetit të Helsinkit për të Drejtat e Njeriut i Republikës së Maqedonisë - Qendrës për Mbështetje LGBTI dhe Avokatit të Popullit të Republikës së Maqedonisë. Qëllimi i bashkëpunimit midis Avokatit të Popullit dhe Qendrës për mbështetje LGBTI është forcimi i kapaciteteve rajonale të Avokatit të Popullit në fushën e të drejtave të njeriut dhe lirive të personave LGBTI, si dhe rritja e sigurisë juridike dhe mekanizmave për mbrojtjen e të drejtave të komunitetit LGBTI në territorin e Republikës së Maqedonisë.

3. INSTITUCIONET

Kriza politike në shoqërinë maqedonase, u thellua dhe zgjati shumë, ndër të tjera, edhe për shkak të pushtimit partiak të institucioneve dhe zbrazjes së tyre nga servisimi i qytetarëve të Republikës së Maqedonisë, si dhe trajtimit të tyre përmes parimit të barazisë dhe pa përjashtim për shkak të karakteristikave të ndryshme.

Një nga shembujt e partizimit të institucioneve përmes të cilave duhet të materializohet parimi i barazisë, ishte ai me zgjedhjen e përbërjes së re të Komisionit për Mbrojtje nga Diskriminimi. Më 11 Janar 2016, nga ana e Kuvendit, u zgjedhën anëtarët e rinj të Komisionit. U vërtetua frika e vitit 2014, kur Rrjeti për Mbrojtje nga Diskriminimi, ku është anëtare edhe Qendra Mbështetëse LGBTI, sinjalizoi se

paqartësitë ligjore lënë hapësirë që për anëtar të Komisionit të zgjidhet kandidat i papërshtatshëm për rolin që duhet ta ketë. Norma të tilla joadekuate rezultuan me zgjedhjen e kuadrove partiakë, të cilët nuk kishin përvojë në sferën e të drejtës kundër - diskriminuese, e as që kishin punuar me grupe të marginalizuara dhe kategori të prekshme. Zgjedhjet më dështuese ishin zgjedhja e Toni Naunovskit dhe e kryetarit të ri të Komisionit, Aleksandar Dashtevski, si mbështetës të politikave që i degradojnë dhe nuk i trajtojnë njëllë grupet e ndryshme socio-kulturore dhe politike në shoqërinë maqedonase.

Një shembull tjetër shqetësues është funksionimi i organeve të Ministrisë së punëve të brendshme. Në vitin e kaluar, vit i krizës së thellë politike dhe shoqërisë së polarizuar, morri hov gjuha e urrejtjes bazuar në orientimin seksual dhe identitetin gjinor. Komuniteti LGBTI ka qenë shënjestër e sulmeve të shumta, sidomos në mediat sociale. Aktivistët civilë që përfaqësojnë të drejtat e komunitetit LGBTI (dhe mbështetësit e tyre) janë sulmuar në media nga ana e qendrave të pushtetit, por edhe nga individë. Ministria e punëve të brendshme nuk ka treguar kurrfarë vullneti e as kompetencë për t'u ballafaquar me gjuhën e urrejtjes, e cila mund të rezultojë edhe me dhunë fizike.

Gjatë vitit 2016, i rëndësishëm ishte profesionalizmi i dy institucioneve, puna e të cilave lidhet me atë të Qendrës për Mbështetje LGBTI, e ato janë Agjencia për Shërbime të Mediave Audio dhe Audiovizuale dhe Këshilli për Etikë në mediat në Maqedoni. Rëndësi të veçantë ka funksionimi profesional i Këshillit, me ç'rast duhet theksuar se me vendimet e veta (edhe në vitet e kaluara) tregoi një shkallë të lartë të profesionalizmit në zbatimin e të drejtës materiale, si dhe në zbatimin e të drejtës që buron nga jurisprudenca e Gjykatës Evropiane për të drejtat e njeriut. Këshilli gjithashtu tregoi një shkallë të lartë të profesionalizmit lidhur me harkun kohor në të cilin u përgjigj në të gjitha ankesat. Nga bashkëpunimi me Këshillin, veçojmë se më 17.02.2016, Qendra për Mbështetje LGBTI, Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut i Republikës së Maqedonisë dhe "Koalicioni për të Drejtat Seksuale dhe Shëndetësore të Komuniteteve të Margjinalizuara" paraqitën një ankesë në Komisionin e Ankesave pranë Këshillit, në lidhje me një artikull të botuar në mediumin elektronik Puls24, me titull "Shkatërrimi i vlerave familjare në mënyrë të planifikuar", i cili ka përmbajtje diskriminuese, ku në mënyrë të vrazhdë shkilet e drejta për të zgjedhur, gjegjësisht mënyra të caktuara të jetës, kualifikohen me urrejtje. Për më tepër, ky artikull përmban shpifje për OJQ-të maqedonase për gjoja financimin dhe planifikimin e "shkatërrimit të familjes". Komisioni solli vendim duke

e mbështetur ankesën si të bazuar. Siç thuhet në vendimin e Komisionit, në këtë artikull është bërë shkelje e neneve 1, 10, 11 dhe 13 të Kodit të Gazetarëve.

4. Mediumet dhe komuniteti LGBTI

Gjatë vitit 2016, ajo që ishte e rëndësishme për përfaqësimin mediatik të komunitetit LGBTI në shoqërinë maqedonase, ishte përfshirja e tij dhe angazhimi politik në luftën për sundimin e të drejtës, barazisë dhe demokracisë. Megjithatë një rol i tillë i komunitetit LGBTI është i qartë, si një subjekt i rëndësishëm politik me një linjë të qëndrueshme të rezistencës ndaj përjashtimit strukturor, diskriminimit dhe degradimit tjetër, përsëri, disa media dhe punonjës të medias pranë partisë VM-RO-DPMNE dhe partnerëve të saj të biznesit, duke i thyer standardet etike të punës në media ose të vërtetën, informimin dhe objektivitetin, treguan një tendencë të qartë mediatike në prezantimin e komunitetit LGBTI si të dëmshëm, devijues, me agjenda sekrete, të ekspozuar në dhunë të pandëshkueshme, të lidhur me aktivitetet mercenare dhe të ngjashme.

Kështu, shumë shpesh ndodh që në materialet e mediumeve, temat LGBTI të trajtohen përmes titujve senzacional (veçanërisht në rubrikat “Show biz”)⁶; tituj që aludojnë në “diçka animale” të komunitetit LGBTI ose bëhet lidhje e komunitetit me egërsi / instinkte dhe lloje të tjera të desubjektivizimit seksist⁷; më tutje, përmes titujve që i referohen dhunës, e cila mbetet pa dënim publik në media⁸, ose tituj përmes të cilave përhapet drejtpërsëdrejti gjuha e urrejtjes. Lidhur me këtë të fundit, shembull i qartë është artikulli në portalin “Puls 24” (së bashku me “Netpress”, “Infomax” dhe një seri artikujsh të tyre) i cili shpreh qartë pozicionin dhe qëndrimin e mediumit në lidhje me homoseksualitetin, përkatësisht të ekipit editorial dhe përgjegjësve për përmbajtjet që plasohen në portal. Gjegjësisht, duke komentuar një artikull në një medium tjetër (“Okno”), sipas portalit “Puls 24”, përmbajtjet në

6 <http://telegraf.mk/zabava/sportshou/ns-newsarticle-ocigledno-ne-e-per-poglednete-ja-georgina-novata-devojkana-ronaldo-foto.nspix>

7 <http://reporter.mk/uncategorized/%D1%84%D0%BE%D1%82%D0%BE-%D0%B8-%D0%B2%D0%BE%D1%9F%D1%83%D0%BD%D0%B3%D0%BB%D0%B0%D1%82%D0%B0-%D1%81%D0%B5%D0%BC%D1%80%D0%B4%D0%BD%D0%B0%D0%B0-%D0%BB%D0%B5%D0%B7%D0%B1%D0%BE%D0%B0%D0%BA%D1%86/>

8 <http://republika.mk/639771>

lidhje me temat për homoseksualitetin janë, domosdoshmërisht “të dhimbshme”, gjegjësisht janë rezultat i “ideve degjenerative”⁹.

Ky shembull, si dhe të tjerët që do të prezentohen në vazhdim, ishin pjesë e mënyrës së paraqitjes mediatike të komunitetit LGBTI gjatë vitit 2016, pavarësisht faktit se Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut ka sjellë vendim sipas të cilit pikëpamjet homofobike (të shprehura në artikuj sipas të cilëve homoseksualiteti është një sëmundje, devijim, hendikep, degjenerativ, etj.) njihen si gjuhë urrejtjeje¹⁰, e jo si liri e shprehjes; përkatësisht, se fjalori diskriminues i bazuar në orientimin seksual është po aq i dëmshëm dhe mund të shkaktojë lëndim personal dhe kolektiv, ashtu si fjalori racist ose fjalori që lidhet me origjinën ose gjuhën e viktimës.

Por, është e rëndësishme të përmendim edhe praktikrat pozitive, në drejtim të kundërshtimit të asaj që u theksua më parë me përdorimin e fjalorit degradues dhe të urrejtjes ndaj komunitetit LGBTI. Një shembull i tillë ishte vendimi i Agjencisë për Shërbime të Mediave Audio dhe Audiovizive, në lidhje me televizionin “Kanal 5” dhe me “deklaratat dhe pikëpamjet e shprehura nga Milenko Nedelkovski në botimet e emisionit të tij “Milenko Nedelkovski Show”, të transmetuar në 15, 22 dhe 29 janar, 5 dhe 12 shkurt 2016, i cili nxiti dhe përhap diskriminim, intolerancë dhe urrejtje bazuar në orientimin seksual, duke shkelur kështu nenin 48 të Ligjit për Shërbimet e Mediave Audio dhe Audiovizive.” Gjegjësisht, sipas Agjencisë, shkelja e ligjit i referohet faktit se “në disa emisione të njëpasnjëshme, të inçizuara më herët, shërbimi i programit televiziv të nivelit shtetëror TV Kanal 5, merr një vendim editorial që t’i mundësojë autorit të emisionit të jetë burim i homofobisë dhe gjuhës së urrejtjes në bazë të orientimit seksual”¹¹. Sipas portalit “Libertas”, “Mbikëqyrja e programit e kryer nga Agjencia për Shërbime të Mediave Audio dhe Audiovizive u realizua sipas detyrës zyrtare dhe i referohet disa emisioneve të “ Milenko Nedelkovski show”, ku ai: flet gjuhën e urrejtjes dhe diskriminimit, përdor fjalor homofobik për të denigruar ata që kanë pikëpamje tjetër politike, barazon homoseksualitetin me sëmundje, etj. Raporti i shqyrton të gjitha aspektet relevante gjatë vlerësimit të një fjalimi si diskriminues, homofobik dhe gjuhë urrejtjeje (konteksti, personi përgjegjës, ekzistimi i qëllimit, përmbajtja, shtrirja dhe fushëveprimi i shprehjes dhe gjasat e ndikimit në audiencë dhe veprimet e ardhshme)”¹².

9 <http://puls24.mk/mk/vesti/portalot-okno-preporacuva-bolna-literatura-za-deca>

10 Vajdeland and Others. vs Sweden, Application no. 1813/07

11 http://www.avmu.mk/images/Izvestaj_KANAL__DOOEL_Skopje.pdf

12 <http://www.libertas.mk/agentsija-za-mediumi-kanal-5-shiri-govor-na-omraza-kon-lgbt-zaednitsata/>

5.Raste

Këtë vit, numri i rasteve individuale të paraqitura në Qendrën mbështetëse LGBTI nuk ka ndryshuar ndjeshëm, krahasuar me vitin e kaluar. Këtë vit, Qendra veproi në 4 raste individuale. Bazuar në këto raste, mund të konkludohet se situata me personat LGBTI mbetet e pandryshuar. Ata ende nuk u besojnë institucioneve dhe kanë nevojë për mbështetje dhe shoqërim gjatë proceseve të iniciuara nga shoqatat e qytetarëve. Diskriminimi në bazë të orientimit seksual dhe identitetit gjinor është përsëri një nga arsyet mbizotëruese për mungesën e ndonjë shërbimi institucional për njerëzit LGBTI.

6.Komuniteti

Si në vitet e mëparshme, edhe këtë vit, mungesa e hapësirave të sigurta ku personat LGBTI mund të shprehin lirisht identitetin e tyre seksual dhe gjinor, u tregua si një nga problemet më të mëdha të komunitetit. Ngjarjet e organizuara nga Qendra LGBTI gjatë vitit të kaluar, treguan se ishin përgjigjja më e përshtatshme ndaj këtij problemi, duke pasur parasysh se këtë vit, pati pjesëmarrje të madhe të personave LGBTI në këto ngjarje.

Grupet mbështetëse që veprojnë brenda Qendrës LGBTI për përkrahje dhe procesi i decentralizimit të lëvizjes LGBTI, përmes formimit të bërthamave lokale LGBTI, kanë çuar në forcimin e komunitetit në aspekte të ndryshme, madje edhe në solidaritet me aktivistët e të drejtave të njeriut dhe solidaritetit midis anëtarëve komunitetit LGBTI, kanë krijuar mundësi më të mëdha për veprimin e vetë komunitetit dhe, në një farë mase, shprehje të qëndrimit të fortë politik kundër mekanizmave represivë që kanë shtypur njerëzit LGBTI për një dekadë.

Valvitja e flamurit me ngjyrat e ylberit, në protestat kundër regjimit dhe pjesëmarrja në protestat e Revolucionit shumëngjyrësh, janë një tregues i patjetërsueshëm që me kalimin e kohës, komuniteti po bëhet i vetëdijshëm politikisht dhe po tregon një qëndrim dhe vizion të qartë politik.

